

INVESTIMI I HUAJ DIREKT NË VENDET NË ZHVILLIM TË EVROPËS LINDORE: RASTI I SHQIPËRISË.

SHTATOR, 2005

ENDRITA XHAFERAJ*



PËRMBAJTJA

Abstrakt	5
1. Hyrje	6
2. Rishikimi i literaturës	8
2.1. Përkufizimet dhe matja	8
2.2. Tipet e IHD-së	11
2.3. Teoritë e IHD-ve	12
2.4. Faktorët përcaktues të IHD-së	15
2.5. Efektet e IHD-së në vendet pritëse	18
2.6. Tendencat botërore të IHD-së	24
3. Metodologjia	26
3.1. Strategjia e kërkimit	26
3.2. Mbledhja e të dhënave dhe mënyra e shtjellimit	26
3.3. Kufizimet dhe mënyra alternative të kërkimit	27
4. Rezultatet e kërkimit dhe analiza	28
4.1. Vendet dhe sfondi historik	28
4.2. Zhvillimi i IHD-ve në rajon	31
4.3. Sektorët, vendet e origjinës dhe nxitjet për IHD-të në rajon	34
4.4. Ndikimi i IHD-së në CEE dhe SEE	36
4.5. Shqipëria	39
5. Përfundime dhe rekomandime	54
5.1. Përmbledhje e gjetjeve	54
5.2. Rekomandime të mundshme dhe ndikimet e politikës	56
Literaturë	58
Aneks 1. Shkurtime për emrat e shteteve të përdorura në grafikë	63
Aneks 2. Lidhja ndërmjet PBB-së dhe IHD-së	64
Aneks 3. Marrëveshjet dypaleshe e rajonale të tregtisë	66

* *Endrita Xhaferaj, specialiste në Departamentin Mbikëqyrjes.*

ABSTRAKT

Investimet e huaja globale patën një rritje të shpejtë gjatë viteve 1995-2000, dhe me pothuaj të njëjtën shpejtësi kanë pësuar rënie që prej vitit 2000. Një tendencë e tillë përcaktohet kryesisht nga investimet rënëse në vendet e zhvilluara, ndërsa vendet në zhvillim vazhdojnë të tërheqin më shumë flukse kapitali. Shpërndarja e investimeve të huaja ndër vendet në zhvillim është e çrregullt: disa prej tyre kanë më shumë vështirësi të tërheqin investimet e huaja sesa të tjerat.

Ky studim analizon zhvillimin dhe shpërndarjen e investimit të huaj direkt në vendet e Evropës Juglindore krahasuar me ato të Evropës Qendrore, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në rastin e Shqipërisë. Investimet e huaja konsiderohen të kenë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në rindërtimin e ekonomive të këtyre vendeve gjatë tranzicionit të tyre nga ekonomi të centralizuara në ekonomi tregu.

Në këtë material, analizohen burimet e mundësitë e Shqipërisë, si edhe pikat e saj të dobëta në kuadrin e ndikimit të tyre në situatën aktuale të investimeve të huaja hyrëse, si dhe me synimin e rekomandimit të strategjive të mundshme për përmirësim të kësaj situatë.

1. HYRJE

Gjatë dekadës së fundit ka pasur rritje të nivelit të Investimit të Huaj Direkt (IHD) që ka shkuar drejt vendeve në zhvillim, dhe që prej vitit 1989, edhe drejt vendeve të Evropës Qendrore e Lindore. IHD në ekonomitë në tranzicion të këtyre vendeve është studiuar shpesh kohët e fundit si për risinë e tij si fenomen ashtu edhe për rëndësinë e tij në rritjen dhe zhvillimin e rajonit.

Është pranuar prej kohësh që përfitimet që sjell IHD për këto vende, janë të rëndësishme e përfshijnë prurjen e teknologjive e njohurive të reja në firmat vendase, “rrjedhjet” e produktivitetit (spillovers), rritje të konkurrencës, si dhe rritjen e mëtejshme të aksesit për eksporte jashtë vendit. Për më tepër, IHD është një mënyrë e preferuar e financimit të deficitit korent (i cili është mjaft i lartë në vendet në tranzicion), meqenëse flukset e IHD nuk krijojnë borxh. Kështu, pavarësisht disa efekteve negative që IHD mund të ketë në vendet pritëse, për vendet e Evropës Qendrore e Lindore, është konsideruar si një burim shumë i rëndësishëm për të ndihmuar rindërtimin dhe tranzicionin e tyre në një ekonomi tregu.

Në këtë rajon, disa vende kanë performuar më mirë se të tjerat në tërheqjen e flukseve të IHD, sidomos kur krahasohen dy grupet kryesore: Evropa Qendrore dhe Evropa Juglindore.

Investimet e huaja direkte në Shqipëri kanë qenë një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen ekonomike, duke ndryshuar gjatë viteve si në formë ashtu dhe në shifra. Megjithatë, Shqipëria është një ndër vendet më pak të zhvilluara të rajonit, duke shënuar tërheqjen më të vogël të IHD-ve gjatë viteve të tranzicionit.

Objektivi kryesor i këtij kërkimi është studimi dhe dhënia e përgjigjeve për pyetjet e mëposhtme:

- Si ka ndikuar ndryshimi i kushteve të tregut të vendeve ish – komuniste të Evropës Lindore gjatë dy dekadave të shkuara në investimet e huaja direkte në këto vende?

- Cilat janë evidencat empirike të tendencave dhe zhvillimeve të IHD-ve në këto vende?
- Cilët janë motivuesit e vërtetë të këtyre investimeve: çfarë burimesh ofrojnë këto vende dhe si i përdorin ato për t'u bërë vende të synuara nga investitorët e huaj?
- Cili është rasti i Shqipërisë lidhur me investimet e huaja direkte në krahasim me vendet e tjera të rajonit?
- Çfarë kushtesh paraqet klima e investimeve në Shqipëri? Cilat janë përparësitë e saj konkurruese për thithjen e investimeve të huaja?
- Si mund të përdoren këto përparësi dhe çfarë nevojitet që Shqipëria të tërheqë më tepër investitorë të huaj?

Materiali ndahet në pesë kapituj. Kapitulli 2 rishikon literaturën ekzistuese mbi fenomenin e IHD-së, teoritë e zhvilluara që shpjegojnë natyrën e këtij fenomeni dhe përcaktojnë faktorët që e shkaktajnë atë, si dhe ndikimin e tij në vendet pritëse. Ky kapitull ofron gjithashtu, një vështrim të shpejtë mbi ecurinë e IHD-së në arenën botërore.

Kapitulli 3 paraqet objektivat kryesorë të këtij kërkimi si edhe rrugën metodologjike të ndjekur për të shtjelluar këta objektiva. Ai ndiqet nga kapitulli i analizës, i cili ndahet në dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë studiohet ecuria e IHD-së në të gjithë rajonin e Evropës Qendrore e Lindore, me vëmendje të veçantë mbi vendet e Evropës Juglindore. Këtu bëhet edhe një përpjekje për të shpjeguar ndikimin e IHD-së në prodhimin ekonomik të këtyre vendeve, duke parë korrelacionin midis flukseve të IHD-së dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Pjesa e dytë e kapitullit të analizës fokusohet në rastin e Shqipërisë, duke diskutuar zhvillimet ekonomike të vendit, ecurinë e flukseve të IHD-së në terma të tipeve të investimeve, sektorëve të ekonomisë ku IHD është përqendruar si dhe vendeve prej nga vijnë investimet. Gjithashtu, në këtë pjesë, është analizuar edhe klima e investimit (burimet e pengesat për IHD) që paraqet Shqipëria.

Kapitulli i fundit përmbledh gjetjet përgjatë kërkimit si dhe rëndësinë e tyre dhe ofron rekomandime modeste për Shqipërinë, me qëllim rritjen e tërheqjes së investitorëve të huaj direktë.

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1. PËRKUFIZIMET DHE MATJA

Statistikat e përdorura gjerësisht për IHD ngrenë disa çështje të rëndësishme konceptuale për përcaktimin dhe interpretimin, si edhe për probleme praktike në lidhje me matjen e tij.

Sipas përkufizimeve të FMN (1993) dhe OECD (1996), Investimi i Huaj Direkt reflekton synimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm të një njësie rezidente në një ekonomi (investuesi direkt) në një njësi rezidente të një ekonomie tjetër (ndërmarrja e investimit direkt). Koncepti i “interesit të qëndrueshëm” nënkupton ekzistencën e një marrëdhënieje afatgjatë midis investitorit direkt dhe ndërmarrjes, si dhe të një ndikimi të konsiderueshëm të investitorit në administrimin e procesit të vendimmarrjes në ndërmarrje. Investimi direkt përfshin transaksionin fillestar midis dy njësive si edhe të gjitha transaksionet pasuese midis tyre.

Një tjetër përkufizim që nënvizon rëndësinë e nocionit të pjesëmarrjes në administrim është ai nga Rugman & Hodgetts, (1995) “Investim i huaj direkt është pronësia dhe kontrolli i asetëve të huaja, që nënkupton pronësinë e plotë ose të pjesshme të një kompanie në një vend të huaj.”

Botimi i pestë i Manualit të Statistikave të Bilancit të Pagesave (FMN 1993), përcakton si investitor direkt zotëruesin e 10 për qind ose të më shumë aksioneve të zakonshme ose të fuqisë votuese të një kompanie në një vend, duke qenë rezident në një ekonomi tjetër. Gjithsesi, ky përcaktim nuk e bën të qartë dallimin mes Investimit të Huaj Direkt e Investimit të Huaj të Portofolit.

“Një nga shkaqet kryesore të shumëllojshmërisë së përkufizimeve të IHD-së vjen nga ndryshimet në rëndësinë që u atribuohet karakteristikave të kompanive që operojnë në arenën ndërkombëtare” (Hood dhe Young, 1979).

Në këtë kuadër, Moosa (2002), argumenton se “Karakteristika e përbashkët e përkufizimeve të IHD-së qëndron në termat si “kontroll”

dhe "fuqi vendosëse", të cilat përfaqësojnë tiparin kryesor që dallon IHD-të nga investimet e portofolit, meqë investitori i portofolit nuk kërkon kontroll mbi ndërmarrjen." Përgjithësisht, një minimum prej 10 për qind i mbajtjes së aksioneve, konsiderohet të lejojë aksionerët e huaj të ushtrojnë një influencë të konsiderueshme mbi ndërmarrjen, nëse do të zgjidhnin ta bënin.

Në kuadrin e ndryshimit të modelit dhe rolit të IHD-së në ekonominë botërore, një grup ekspertësh nga FMN dhe OECD arritën në përfundimin që është koha e duhur të rishikohet përkufizimi i tyre, i përmendur më sipër. Në vitin 2003, u krijua një grup i përbashkët FMN/OECD (Direct Investment Technical Expert Group DITEG), për të koordinuar shtjellimet metodologjike dhe për të siguruar harmonizimin mes rekomandimeve të tyre. Një ndërmarrje e tillë do të kërkojë disa vite e kryesisht do të rishikojë konceptet e përkufizimit ekzistuese nën dritën e analizave dhe eksperiencave të tyre praktike në vendet anëtare të OECD-së, si dhe do të përfshijë koncepte e përkufizime të reja, të cilat kanë marrë rëndësi për aktivitetet e IHD-së që nga rishikimi i fundit. Për shembull, një nga rekomandimet që doli nga takimi i diskutimit i OECD mbi Statistikat e Investimeve Ndërkombëtare (WIIS) mbajtur në tetor 2004 dhe prill 2005, ishte ndryshimi nga 10 në 20 për qind i kufirit të përdorur në përcaktimin e IHD-së (OECD, 2005).

Interesi për fenomenin e IHD-së, që ka motivuar përpjekjet e vazhdueshme për të nxjerrë teori që shpjegojnë shkaqet e pasojat e tij, sipas Moosa (2002), i atribuohet arsyeve të ndryshme. Arsyeja e parë është rritja e shpejtë e flukseve të IHD-së dhe modeleve të tyre, sidomos pas viteve 1980. Moosa sjell fakte që tregojnë se flukset e IHD-së vazhdojnë të rriten edhe kur tregtia botërore ngadalësohet; për shembull kur rritja e tregtisë frenohet nga pengesa të tregtisë, IHD mund të rritet si një përpjekje e kompanive për të shmangur këto pengesa. Arsyeja e dytë e interesit mbi IHD-të është shqetësimi që ngrihet për shkaqet dhe pasojat e pronësisë së huaj. Një arsye tjetër për të studiuar IHD-të rrjedh nga fakti që ai ofron mundësinë e kanalizimit të burimeve drejt vendeve në zhvillim. Duke ndjekur këtë arsyetim, IHD bëhet një burim i rëndësishëm fondesh në një kohë kur mundësia e gjetjes së mënyrave të tjera të financimit vjen gjithmonë duke u zvogëluar.

Së fundi, një arsye e rëndësishme lidhur me qëllimin kryesor të këtij materiali, është që IHD mendohet të luajë një rol shumë të rëndësishëm në transformimin e vendeve ish-komuniste. Kjo sepse IHD bashkë me kursimet e brendshme kontribuojnë në investimet totale të ekonomisë pritëse. Gjithashtu, IHD sjell me vete teknologjinë e përparuar, aftësitë administruese dhe hyrjen në tregjet e eksportit.

2.1.1. Vështirësitë praktike në matje

Statistikat e IHD-ve janë pjesë e statistikave të bilancit të pagesave dhe hartohen e prezantohen nga vendet sipas udhëzimeve të FMN-së. Ekzistojnë vështirësi praktike serioze në hartimin e këtyre statistikave, veçanërisht në rastin e vendeve në zhvillim ku qeveritë jo gjithmonë kanë mjetet e duhura për mbledhjen e të dhënave statistikore në mënyrë sistematike.

Për më tepër, edhe vendet e zhvilluara që kanë mekanizmat e përshtatshëm për mbledhje statistikash, kanë vështirësi. Këto burojnë nga fakti se secili vend përdor standarde të ndryshme kontabiliteti, si dhe koncepte e përkufizime të ndryshme.

Duke u kthyer te Moosa (2002), ai shpjegon se: “Ekzistojnë probleme për matjen e IHD-së, sidomos në rastet kur investimi është në formën e pajisjeve ose të teknologjisë së kapitalizuar. Gjithashtu, ka mospërputhje të informacionit mbi IHD nga vendet e burimit me ato pritëse. Shumë vende nuk publikojnë informacion të hollësishëm mbi aktivitetin e kompanive të tyre jashtë vendit, për arsye të ruajtjes së fshehtësisë”.

Jo më pak i rëndësishëm është edhe konfuzioni midis IHD-së, që “supozohet të jetë kontraktuar” duke u bazuar në letra e kontrata të firmosura në marrëveshjet paraprake dhe IHD-së së realizuar në fakt (parave që janë investuar në realitet).

Si rrjedhim i problemeve të mësipërme, statistikat e IHD-së në pjesën më të madhe të vendeve, por veçanërisht në vendet në zhvillim, janë subjekt i shumë gabimeve e harresave.

2.2. TIPET E IHD-SË

Është e rëndësishme të evidentohen dallimet mes tipeve të ndryshme të IHD-së dhe kompanive investuese, në mënyrë që të jenë më të qarta arsyet për të cilat një kompani vendos të investojë në një vend të caktuar. Autorë të ndryshëm i kanë klasifikuar IHD-të sipas pikëpamjeve të ndryshme.

Si pjesë e “paradigmës OLI”, Dunning (1993) identifikoi katër kategori kryesore të investitorëve të huaj, të cilat janë përdorur më pas nga shumë studiues të tjerë në analizat e tyre: kërkuesi i rendimentit; kërkuesi i tregut; kërkuesi i burimeve; dhe kërkuesi i aseteve strategjike. Kërkuesi i rendimentit motivohet në investimet e tij nga përparësitë e thjeshta të drejtimin të aktiviteteve të shpërndara gjeografikisht (ekonomitë e shkallës dhe diversifikimi i rrezikut). Qëllimi është përfitimi nga përparësitë që mund të ofrojnë ndryshimin në koston e faktorëve të prodhimit, kultura, marrëveshjet institucionale, sistemet ekonomike e politike dhe strukturat e tregut. Kërkuesit e tregut motivohen nga dëshira për të hyrë në tregjet e vendit pritës ose vendeve fqinje me të (tregjet rajonale). Kërkuesi i burimeve ndërmerr një investim të huaj direkt për të përftuar burime/pasuri specifike që janë të disponueshme në vendin pritës me një kosto më të ulët. Këto mund të jenë: burime fizike me kosto më të ulët e siguri oferte; forcë pune e aftë ose gjysmë e aftë, por e lirë dhe e motivuar; mundësi teknologjike si dhe ekspertizë administrimi ose marketingu e aftësi organizuese. Kërkuesi i aseteve strategjike hyn në një investim të huaj direkt me qëllim përfitimin e një asemi të rëndësishëm, që i përmirëson atij pozicionin konkurrues në treg. Në praktikë ka një ndërthurje midis këtyre kategorive, që e bën të vështirë vendosjen e një kompanie në një kategori të vetme.

Nga këndvështrimi i investitorit (vendi i origjinës së IHD-së), Caves (1971) dallon midis IHD-ve horizontale, vertikale dhe konglomerat. IHD horizontale ndërmerret me qëllim prodhimin e produkteve të njëjta ose të ngjashme me ato që prodhohen në vendin e origjinës. Si rrjedhim, ai konsiston në duplikimin e të gjithë procesit prodhues në disa vende, përveç aktivitetit të zyrave qendrore. Çdo degë e huaj prodhon kryesisht për tregun vendor dhe ka pak tregti midis

njësive në vende të ndryshme. IHD vertikale, nga ana tjetër, konsiston në ndarjen gjeografike të fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit. Kështu, nxitet tregtia përtej kufijve (brenda kompanisë) dhe rritet tendenca e degëve për të eksportuar. IHD konglomerat mund të jetë një përzierje e investimeve horizontale e vertikale, e të përfshijë edhe investimin në një industri të një natyre tjetër në vendin pritës. Autorë të ndryshëm e kanë klasifikuar IHD sipas orientimit ndaj eksportit. Nga ky kënd vështrimi, Kojima (1978) i klasifikon investimet e huaja në të orientuara drejt tregtisë (që gjenerojnë një kërkesë të rritur për importe e një ofertë të rritur për eksporte) ose të orientuara kundër tregtisë, që kanë një efekt negativ mbi tregtinë. Ai nënvizon se përparësitë krahasuese të industrive në vendet e origjinës e ato pritëse, janë vendimtare për të përcaktuar nëse IHD është e orientuar nga tregtia apo kundër saj. Në vendet pritëse në zhvillim, IHD që shkon në industritë me përdorim intensiv të krahut të punës, ka shumë gjasa të jetë tregtikrijuese, ndërsa IHD që shkon në industritë me përdorim intensiv të kapitalit është më shumë tregtizëvendësuese ose tregtishkatërruese.

Kjo teori është përpunuar më tej nga Narula (1996), i cili klasifikon IHD-të në zëvendësuese të tregtisë - që shkojnë drejt aktiviteteve që zëvendësojnë importet në furnizimin e tregjeve të brendshme; promovuese të tregtisë - që kanë për qëllim furnizimin e tregjeve të tjera; plotësuese të tregtisë - kur drejtohen në prodhimin e racionalizuar të pajisjeve ndihmëse në tregjet e eksportit; dhe shmangies të tregtisë - nëse synojnë të përdorin pjesë të papërdorura të tregut, me marrëveshje tregtie preferenciale.

Së fundi, Meyer (1998) bën dallimin mes investitorëve të huaj, të drejtuar nga tregjet që synojnë tregje vendase ose rajonale; të drejtuar nga çmimi i faktorëve që synojnë shitjet ndërrajonale brenda firmës; dhe investitorë të huaj që janë një kombinim i dy llojeve të mësipërme, domethënë të drejtuar nga tregjet dhe çmimi i faktorëve.

2.3. TEORITË E IHD-VE

Investimi i huaj direkt në përgjithësi dhe implikimet e tij për vendet në zhvillim në veçanti, janë çështje që janë studiuar në mënyrë

të gjerë. Një teori shumë e rëndësishme që shpjegon aktivitetin e kompanive shumëkombëshe dhe IHD-së, përreth së cilës është zhvilluar kryesisht e gjithë literatura mbi kompanitë shumëkombëshe, është “Teoria Eklektike” e Dunning (1981). Paradigma OLI ofron një shpjegim të plotë të mënyrave më të mira për të hyrë në tregjet e huaja. Ajo është një strukturë shumë e dobishme që përmbledh karakteristikat e ndryshme të mundësive të ndërmarrjes që të kthehet në shumëkombëshe, dhe ka ndihmuar në vlerësimin empirik të këtij fenomeni. Kjo paradigmë është përzierje e tre teorive të ndryshme dhe merr në konsideratë tre faktorë:

- *Përparësitë e pronësisë (Ownership advantage)*: përparësitë krahasuese, specifike për firmën, qëndërmarrja shumëkombëshe ka ndaj firmave vendase për t’i shërbyer tregjeve të veçanta. Këto mund të jenë produkte ose procese prodhimi apo reputacioni për cilësinë, që firmat vendase nuk i kanë.
- *Përparësitë specifike të vendndodhjes (Location - specific advantages)*: të cilat janë motivime shtesë për IHD që i jepen ndërmarrjes shumëkombëshe nga përparësitë specifike të vendit të huaj në të cilin ajo investon, si: materiale të para shtesë, kosto më e ulët e prodhimit, kosto e lartë e transportit për kompaninë ose preferencë e tregut.
- *Përparësitë e trupëzimit (Internalisation advantages)*: faktorë që ndikojnë firmën në vendimin për të prodhuar të mirat ose shërbimet vetë apo për t’u mbështetur në një prodhues lokal. Zgjedhja e mënyrës që përdor ndërmarrja shumëkombëshe për të hyrë në tregun e huaj varet nga këta faktorë.

Të gjithë faktorët e përmendur më sipër, bashkë me të tjerë si disponueshmëria e rezervave, strategjia e përgjithshme e firmës etj., ndihmojnë firmën të zgjedhë mes IHD-së, eksportit, kompanisë së përbashkët apo alternativave të tjera.

Një teori tjetër që shpjegon ekzistencën e ndërmarrjeve shumëkombëshe dhe IHD-së është ajo e “Kostos së Transaksionit/Trupëzimit” (Transaction Cost/Internalisation), e krijuar fillimisht nga Williamson (1975), e zhvilluar më vonë nga Buckley dhe Casson (1976), dhe e përpunuar më tej nga shumë autorë të tjerë. Williamson shpjegon pse mund të jetë më me përparësi

përqendrimi në aktivitete të caktuara brenda firmës sesa mbështetja në mekanizmat e tregut (si për shembull, të licencojë apo të nënkontraktojë) për të arritur të njëjtët objektiva. Ai argumenton se kur kostot e ndryshme të transaksionit, të përfshira në operimin me mekanizmat e tregut, janë më të larta sesa ato që burojnë nga ndërmarrja e aktiviteteve brenda firmës, do të preferohej trupëzimi (internalisation) – që mund të bëhet duke krijuar një filial të huaj. Buckley dhe Casson (1976) e aplikuan të njëjtin model për tregjet ndërkombëtare. Ata shpjegojnë se ndërmarrjet shumëkombëshe krijohen kur kostot shtesë të trupëzimit nëpërmjet IHD-së, janë më të vogla se përfitimet nga kostot më të ulëta të transaksioneve.

Duke ndjekur të njëjtën logjikë, Hood dhe Young (1979) i konsiderojnë IHD-të si rrjedhim i mungesës së perfeksionit të tregjeve, në të gjithë botën. Sipas modelit të tyre, përparësitë që këto tregje joperfekte krijojnë, u japin ndërmarrjeve shumëkombëshe mundësi të konkurrojnë në një ambient të huaj. Përparësitë mund të burojnë nga: aftësi teknologjike e marketingu; strukturë e sjellje oligopolistike e tregjeve; kapacitet administrues me tepri; faktorë financiarë e monetarë që përfshijnë kapital të lirë e diversifikim investimesh; mundësi përdorimi të lëndëve të para etj..

Studiues të ndryshëm kanë shtjelluar teoritë e tyre mbi IHD-të, duke u bazuar në modelin oligopë do të ndjekin njëri - tjetrin në tregjet e huaja, në mënyrë që të mbrojnë pozicionet e tyre. Hood dhe Young (1979) shkojnë më tej duke argumentuar se kur një firmë e ka krijuar një pozicion në një pjesë të veçantë të tregut, firmat konkurrencte do ta ndjekin atë për të parandaluar rritjen e përparësive të krijuara tashmë nga kjo firmë. Gjithsesi, kjo teori nuk shpjegon arsyet e investimit të firmës që shkon e para drejt tregjeve të huaja.

Edhe teoria e ciklit të jetës së produktit, e zhvilluar nga Vernon (1966, 1974) ofron një shpjegim teorik për vendimin e ndërmarrjes së IHD-së. Sipas tij, ky vendim ka të bëjë më shumë me vetë biznesin sesa me shtetet, çka është në thelb e vërtetë për kompanitë që bëjnë ose e marrin në konsideratë IHD. Ky model e vë theksin mbi rolin e risisë së produktit dhe efektet e ekonomive të shkallës në ecurinë e tregtisë përtej kufijve kombëtarë. Ai sugjeron që

konkurrenca për koston më të ulët e çon prodhimin jashtë vendit, dhe konkurrenca vjen e rritet ndërkohë që produkti maturohet e standardizohet. Fillimisht, prodhimi i huaj zhvendoset në vende të tjera të industrializuara për t'i shërbyer tregut të vendit pritës, e pastaj eventualisht spostohet në vendet në zhvillim që mund të ofrojnë përparësitë konkurruese specifike për vetë vendin. Kjo teori përcakton fazën e rritjes – në ciklin e jetës së produktit – si faza kur eksportet rriten dhe investimi i huaj shkon për fabrika prodhuese në vende që kanë kërkesë në rritje për produktin.

Teoria e ndarjes ndërkombëtare të punës (Kojima, 1978) bazohet në parimin e koston krahasuese. Sipas kësaj teorie, IHD përdoret zakonisht nga vendet e industrializuara (për shembull, Japonia) për të krijuar një kapacitet të industrisë përpunuese në një vend pritës, në sektorë në të cilët po humbasin përparësitë krahasuese në vend. Nga ana tjetër, kjo industri nuk është shumë e zhvilluar por po bëhet konkurruese në vendin pritës. Këto investime janë të orientuara drejt eksportit; ato supozohet të ushqejnë kërkesën në vendin e origjinës e në të njëjtën kohë, të krijojnë një tregti të balancuar midis të dyja vendeve.

2.4. FAKTORËT PËRCAKTUES TË IHD-SË

Një arsye e fortë që do të motivonte një firmë për të krijuar lehtësi prodhimi jashtë, në vend që të eksportoje atje prodhimet e veta apo të kontraktonte një ndërmarrje vendase, do të ishte perspektiva e fitimeve më të mëdha. Karakteristikat që duhet të ketë vendi pritës për të gjeneruar fitime më të larta për firmën dhe që përcaktojnë vendimin e saj për të investuar jashtë, janë shumë dhe të ndryshme, e janë analizuar thellë e gjerë në literaturë.

Një kontribut të rëndësishëm teorik për këtë çështje ka dhënë “teoria e diamantit” (diamond theory) e Porter (1990), e cila bazohet në katër faktorë që përkufizohen si përcaktuesit e vendit:

- Kushtet e faktorëve – faktorët e prodhimit përfshijnë rezervat natyrore si edhe ato të krijuarat si fuqia punëtore e kualifikuar apo infrastruktura.

- Kushtet e kërkesës – natyra e kërkesës së vendit për të mira e shërbime si dhe niveli i blerësve;
- Industritë e lidhura e mbështetese – ekzistenca në treg e furnizuesve të tjerë apo e industrive të afërta me atë të investimit; dhe
- Strategjia, struktura dhe rivaliteti i firmës – konkurrenca e firmave vendase dhe kushtet e krijimit, organizimit dhe administrimit të kompanisë.

Këta katër faktorë “diamant”, së bashku me rolin e qeverisë në ekonomi dhe rolin e ngjarjeve të rastësishme, promovojnë ose ndalojnë krijimin e kushteve konkurruese për ndërmarrjet.

Në përgjithësi, faktorët përcaktues që ndikojnë në zgjedhjen e vendit ku ndërmarrjet shumëkombëshe vendosin të investojnë, mund të klasifikohen në dy kategori: të lidhur me vendin e origjinës dhe të lidhur me vendin pritës. Variablat e lidhur me vendin e origjinës janë faktorë që e bëjnë investimin jashtë më tërheqës se sa ai në vend, për shkak të kushteve aktuale të vendit. Faktorët e lidhur me vendin pritës e bëjnë investimin në atë vend në veçanti më tërheqës sesa mundësia e investimit në çdo vend tjetër. Në literaturë, faktorët e lidhur me vendin pritës janë ata , të cilët kanë tërhequr më shumë vëmendjen.

Në World Investment Report 2002 (Raporti Botëror mbi Investimet), UNCTAD prezantoi një indeks të ecurisë së IHD-së hyrëse (Inward FDI Performance Index), për të vlerësuar suksesin e vendeve në tërheqjen e IHD-së. Sipas analizës, vendet me vlerë të lartë të këtij indeksi mund të kenë regjime rregullatore jashtëzakonisht mikpritëse, janë të administruara shumë mirë në drejtimin makroekonomik ose kanë një ambient biznesi shumë efikas e me kosto shumë të ulëta. Ato mund të ofrojnë edhe stimuj të tjerë konkurrues si: perspektivë e mirë rritjeje, forcë pune të bollshme e ekonomike, burime natyrore, aftësi më të mira kërkimi e zhvillimi, infrastrukturë të përparuar, mbështetje të mirë financiare e organizim të mirë të furnizuesve. Gjithashtu, ato mund të jenë të privileguara për hyrje në vende të favorizuara për eksportim në tregje të mëdha. Nga ana tjetër, vendet me një vlerë të ulët të indeksit në fjalë, mund të vuajnë paqëndrueshmëri, strukturë të

dobët politikash e dobësi të tjera të theksuara në ekonomitë e tyre (UNCTAD, 2002).

Politikat e qeverive kanë një impakt të rëndësishëm në IHD. Veçanërisht qeveritë e vendeve të pasura e të zhvilluara bëjnë përpjekje të konsiderueshme për të inkurajuar investimet jashtë vendit nga ndërmarrjet e tyre, me qëllim të sigurojnë mundësi për të përdorur burime natyrore ose të rrisin eksportet e makinerive e pajisjeve, e në të njëjtën kohë, të gjenerojnë hyrje kapitali që përmirësojnë bilancin e pagesave. Ndërkohë qeveritë e vendeve më pak të zhvilluara ose në zhvillim, mund të punojnë në drejtim të zbatimit të politikave që u ofrojnë stimuj IHD-ve hyrëse, por çka është edhe më e rëndësishme, të fokusohen në përmirësimet e përparësive krahasuese të vendeve të tyre, duke përmirësuar pozicionin e tyre makroekonomik ndaj konkurrentëve të tjerë.

Dunning (1993) argumenton se motivet dhe faktorët përcaktues të IHD-së kanë ndryshuar në kohë. IHD drejt vendeve në zhvillim është zhvendosur nga kërkues tregu drejt IHD kërkues të burimeve e të rendimentit (vertikal). Vendet në zhvillim duhet t'i tërheqin IHD-të nëpërmjet:

- *Kushteve më të mira të tregut të punës*, që nuk nënkuptojnë vetëm fuqi punëtore me pak shpenzime por edhe produktivitet, fleksibilitet dhe përshtatshmëri të fuqisë punëtore në vendin pritës. Si rrjedhim, vendi duhet të ofrojë fuqi punëtore relativisht të aftë e të arsimuar (nënkuptohet që vendi duhet të ketë një sistem të përshtatshëm arsimor).
- *Strukturës institucionale*. Përveç tarifave të favorshme të taksave, administrata publike duhet të jetë fleksibile sa duhet për të inkurajuar investitorët. Institucionet vetë duhet të jenë elastike dhe dokumentacionet e nevojshme e procedurat e regjistrimit, më pak të ndërlikuara për investitorët e huaj.
- *Përmasat e tregut*. Përmasa e tregut të një vendi pritës nuk mund të matet vetëm nga popullsia e tij. Mund të ketë edhe faktorë të tjerë domethënës, sidomos faktorë të tillë si fuqia blerëse e popullsisë vendase, afërsia dhe lidhjet me vende të tjera të lidhura me të, konkurrenca ekzistuese në vendin pritës e të tjera.

2.5. EFEKTET E IHD-SË NË VENDET PRITËSE

“Kur analizohen efektet e IHD-së në ekonomitë pritëse, ndodh shpesh të bëhet dallimi mes dy grupeve të gjera efektesh, konkretisht efektet direkte dhe efekte indirekte” (Blomstrom, 1989). Efektet direkte, sipas Blomström mund të ndikojnë: në fuqinë punëtore vendase, duke shtuar më shumë mundësi punësimi dhe pagesa më të larta; mbi konsumatorët në formën e çmimeve më të ulëta; dhe mbi qeveritë nëpërmjet të ardhurave më të larta nga taksat. Brenda një vendi pritës, firmat me pronësi të huaj zakonisht paguajnë rroga më të larta se ato vendase. Nuk ndodh gjithmonë që ato të shkaktojnë rritjen e rrogave edhe në firmat vendase, por prania e tyre përgjithësisht e rrit nivelin e pagave në vendin pritës.

Efektet indirekte janë efektet e jashtme që ndryshe janë quajtur “rrjedhje” (spillovers). Termi “rrjedhje” përkufizon efektet indirekte, të gjeneruara nga prania e kompanive të huaja, në strukturën industriale të vendit pritës dhe në ecurinë e firmave vendase. Këto u shtjelluan më tej e u grupuan në “rrjedhje të produktivitetit” dhe “rrjedhje të hyrjes në treg”, nga Blomström dhe Kokko (1998). Sipas kësaj ndarjeje “rrjedhje të produktivitetit” krijohen kur: një firmë vendase përmirëson produktivitetin e vet duke kopjuar disa teknologji të përdorura nga dega e ndërmarrjes shumëkombëshe që operon në tregun vendas; hyrja e një filiali të ri çon në rritje të konkurrencës në ekonominë pritëse dhe i detyron firmat vendase të përdorin më me efikasitet burimet dhe teknologjinë e tyre ekzistuese; vetë firmat vendase, të detyruara nga rritja e konkurrencës, fillojnë të kërkojnë për teknologji të reja më efikase. “Rrjedhje të hyrjes në treg”, ka në rastet kur firmat vendase bëhen më të afta të administrojnë vetë të gjitha aspektet komplekse të trupëzimit të kostove (marketingun, shpërndarjen dhe mirëmbajtjen), të detyruara nga prania e ndërmarrjes shumëkombëshe. Kjo mund të ndodhë sepse firmat vendase mund të jenë nënkontraktore ose furnizuese të ndërmarrjes shumëkombëshe, dhe mësohen të bëjnë punën e tyre ose thjesht sepse kopjojnë atë çka bën kompania e huaj.

“IHD është shumë i dëshiruar nga vendet, veçanërisht për “rrjedhjet” që gjeneron, si administrim e teknologji më e mirë. Përfitimet janë të prekshme. Siç është e vërtetë për firmat që bëjnë

tregti dhe firmat e sektorët ku IHD është më i theksuar, kanë mesatare më të lartë të produktivitetit të fuqisë punëtore dhe paguajnë paga më të larta. Investimet jashtë stimulojnë eksportet e makinerive e pajisjeve dhe rrisin kërkesën për produkte ndërmjetëse, ekspertizë e shërbime të specializuara.” (OECD, 1998.)

Hood dhe Young (1979) analizuan dy qëndrime të ndryshme ndaj efekteve të IHD-së në vendet pritëse. Së pari, teoria Neo-Klasike shpjegon se përfitimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta të vendit pritës nga IHD-të rritëse, vijnë nga të ardhurat më të larta nga taksat, ekonomitë e shkallës dhe ekonomia me jashtë, në përgjithësi. Efektet në bilancin e pagesave në fakt mund të jenë edhe negative, dhe mungesa e konkurrencës perfekte mund të jetë arsye që përparësitë e kostos së ndërmarrjes shumëkombëshe të jenë më të larta në një vend të ndryshëm nga vendi pritës.

Duke konsideruar që modeli Neo-Klasik mund të jetë tepër i thjeshtë e me vlerë të kufizuar, qëndrimi alternativ që Hood dhe Young (1979) ofrojnë është, të rishikohen katër drejtime nga të cilat burojnë përfitimet apo humbjet:

- *Efektet e transferimit të burimeve:* firma e huaj mund të kontribuojë pozitivisht nëpërmjet ofrimit të kapitalit, teknologjisë e administrimit. Sidomos është i rëndësishëm sigurimi i kapitalit, përveç rasteve kur ky kapital sigurohet në vendin pritës, me disavantazhin që kursimet e brendshme mund të ishin përdorur më me produktivitet, diku tjetër në ekonomi. Edhe përfitimet nga teknologjia varen shumë nga kushtet nën të cilat është transferuar e nga përshtatshmëria e saj.
- *Efekte në tregti dhe bilancin e pagesave:* Bilanci i pagesave përfiton fillimisht nga çdo fluks hyrës kapitali. Këtij përfitimi i kundërvihet fluksi i vazhdueshëm dalës i dividendëve, interesave e pagesave administrative bërë kompanisë - mëmë. Një tjetër çështje e rëndësishme është ajo e çmimit të transferimit (çmimi me të cilin bëhet shitja e mallrave brenda firmës, pavarësisht nëse firma ka shtrirje në disa shtete). Edhe ndikimi që ka investimi i huaj në nivelet e importeve e eksporteve është i rëndësishëm, si në lidhje me bilancin e pagesave ashtu edhe me rritjen ekonomike.

- *Efektet konkurruese e jokonkurruese*: Duke iu referuar IHD-së në vendet në zhvillim, ndërmarrjet shumëkombëshe mund të zotërojnë fuqi më të madhe ekonomike sesa konkurruesit vendas, por efektet e tyre në ecurinë e ekonomisë do të varen nga forma e investimit, situata e konkurrencës në vend dhe shkalla e zhvillimit ekonomik të vendit pritës.
- *Efektet në pavarësi e vetëqeverisje*: IHD, në mënyrë të pashmangshme përfshin edhe pak humbje të pavarësisë për vendet pritëse, duke qenë se vendimmarrja përfundimtare i takon kompanisë-mëmë jashtë vendit. Si rrjedhim, zvogëlohet disi mundësia e qeverisë pritëse (sidomos në vendet në zhvillim) të ndjekë politikat e dëshiruara prej saj në fusha si taksimi, tregtia etj..

Megjithëse përfitimet nga IHD-të në vendet pritëse janë pranuar gjerësisht, Brewer (1993) argumenton se ekziston një konflikt mes interesave të ndërmarrjeve shumëkombëshe dhe atyre të vendeve pritëse. Ndërmarrjet shumëkombëshe kërkojnë tre kushte kryesore: mundësitë ku kostot e prodhimit janë më të ulëta; shitje ku çmimet janë më të larta; dhe riatdhesim të fitimeve në vendin e origjinës. Nga ana tjetër, vendi pritës kërkon të maksimizojë përfitimet për ekonominë e tij, çka kërkon mundësisht akoma më shumë investim e mbajtje të fitimit të ndërmarrjeve të huaja brenda vendit.

“Investimi i huaj direkt mbart me vete perceptime të përziera e shpesh të papeshuara mirë [...] megjithëse ekonomia vendase mund të përfitojë nga kompanitë e huaja në mënyra të ndryshme, në mënyrë të pashmangshme ka një farë humbjeje të pavarësisë, kur një segment i gjerë i industrisë vendase kontrollon nga kompani të huaja.” (Neale dhe Pass, 1990, faqe 32.)

2.5.1. IHD-të dhe Evropa Qendrore e Lindore: Kuadri Teorik

Ekziston një literaturë mjaft e pasur mbi investimet e huaja direkte në vendet me ekonomi në tranzicion në përgjithësi, dhe mbi ato të Evropës Qendrore dhe Lindore, në veçanti. Vrojtuesit janë përqendruar në dy pika kryesore: analizën e përcaktuesve të investimeve të huaja direkte, duke përfshirë studimin e lidhjes

ndërmjet klimës së investimeve dhe IHD-ve, dhe analizën e impaktit të IHD-ve në ekonominë e vendit si nga pikëpamja makroekonomike (rritja ekonomike e mbarëvajtja e tregtisë) ashtu edhe nga ajo mikroekonomike (ristrukturimi e ecuria e ndërmarrjes).

2.5.2. Impakti i IHD-ve në Evropën Qendrore e Lindore

IHD është promovuar nga organizata të rëndësishme ndërkombëtare si një motor që luan një rol kryesor në tranzicionin e vendeve të Evropës Qendrore e Lindore nga ekonomi të centralizuara në ekonomi tregu, dhe integrimin e tyre në ekonominë botërore. (FMN 1997, UNCTAD 1998.)

Në përgjithësi, flukset hyrëse të kapitalit të huaj kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të rëndësishme për rindërtimin e Rajonit të Evropës Qendrore dhe Lindore (veçanërisht për vendet e Evropës Juglindore), dhe për riintegrimin e tij në ekonominë botërore. “Kalimi i suksesshëm [nga ekonomi të planifikuara në ekonomi tregu] në Evropën Qendrore dhe Lindore nuk mund të realizohet pa ndihmën e flukseve të mëdha hyrëse të kapitalit të huaj” (Schmidt, 1995). Në një analizë vrojtimi ekonomik të Evropës në vitin 2005, thuhet se ndër llojet e ndryshme të flukseve të kapitalit, investimet e huaja direkte përgjithësisht konsiderohen si më të dëshirueshmet. Një vend mund të përfitojë mjaft nga IHD-të, pa qenë i varur njëkohësisht nga flukset hyrëse neto të kapitalit ose pa nevojën e rritjes së borxhit të tij të jashtëm neto (UNECE, 2005). Dihet se investimet e huaja direkte kanë një ndikim pozitiv mbi ecurinë ekonomike të një vendi. IHD-të kanë një ndikim të madh mbi treguesit kryesorë makroekonomikë si për shembull, mbi prodhimin e brendshëm bruto, bilancin e pagesave dhe mbi punësimin.

“Qoftë direkt apo i portofolit, investimi ndërkombëtar përmirëson shpërndarjen e burimeve botërore duke drejtuar kursimet botërore atje ku janë më produktive, duke u lejuar vendeve pritëse të ruajnë nivele të qëndrueshme të investimit dhe konsumit në vend të luhatjeve në të ardhurat e tyre, si edhe duke u dërguar sinjale të rëndësishme vendeve pritëse në lidhje me qëndrueshmërinë e politikave të tyre”. (OECD, 1998, faqe 28.)

2.5.3. Përcaktuesit e IHD-ve në Evropën Qendrore dhe Lindore

Literatura empirike ofron kërkime që hetojnë mbi qëllimin, strukturën dhe motivimin e IHD-së perëndimore në Evropën Lindore, në nivel rajonal. Ekziston një marrëveshje e përgjithshme lidhur me përcaktuesit kryesorë të investimeve të huaja direkte në vendet me ekonomi në zhvillim të Evropës Qendrore dhe Lindore (Lankes dhe Venables, 1996; Resmini, 2000). Këta faktorë kryesisht përfshijnë: koston e ulët me punë të kualifikuar, dhënien e burimeve natyrore, mundësitë afatgjata të tregut, progresin në reformat e tranzicionit, përmasat e tregut të vendit pritës, si dhe stabilitetin ekonomik dhe politik. Pa dyshim, mungesa ose ecuria e dobët e këtyre treguesve do të ishte pengesë për IHD-të në vendin përkatës.

London dhe Ross (1995) kanë adoptuar teorinë e kapitalizmit global, e cila shpreh se investitorët e vendeve të zhvilluara kanë për tendencë, të investojnë më tepër në vendet e Botës së Tretë, të cilat shfaqen të dobëta dhe ku kostoja e punës është më e ulët. Autorët e kësaj teorie mendojnë se kontrolli i punës dhe kostoja e saj janë përcaktues kryesorë të IHD-ve, pavarësisht nga niveli i zhvillimit.

Studimet e botuara nga OECD (1994) dhe BERZH (1994) kanë sfiduar në mënyrë të konsiderueshme “teorinë e pagës së ulët”. Përfundimi i përgjithshëm i BERZH-it (1994) ishte i drejtpërdrejtë: “Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në vendimarrjen e investitorit, aksesit në treg është ndoshta më kryesori [...] Përparesitë e faktorit të koston renditen si më pak të rëndësishme sesa aksesit në treg në të gjitha vrojtimitet...” Rezultatet e studimit të OECD (1994), i cili bëri një vlerësim të klimës së biznesit në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në shtetet e reja të pavarura të ish-Bashkimit Sovjetik, janë mjaft të ngjashme. Motivi kryesor për IHD-të ishte arritja e aksesit në treg (44 për qind), ndërkohë që kostoja e punës u vlerësua me rëndësi dytësore (vetëm 9 për qind). Në mënyrë të ngjashme, konkluzionet e raportit të Petrakos (1996) mbi Rajonin Greko – Bullgaro – Shqiptar paraqesin të tjera motive për IHD. Komentet e tij ishin: “Për Greqinë [...] flukset dalëse të kapitalit shoqërohen në më të shumtën e rasteve me një ekspansion (dhe jo thjesht zhvendosje) të aktivitetit në tregje të reja, që janë më të

lehta për t'u arritur sesa ato të Evropës Perëndimore, që janë të ngjeshura e ku është vështirë të konkurrosh...".

Klima e investimeve ka një impakt të madh mbi flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte. Ky faktor theksohet veçanërisht në rastin e krahasimit të ecurisë së mirë të vendeve të zhvilluara e në tranzicion të Evropës Qendrore dhe ecurisë së dobët të shteteve të Ballkanit, të cilat janë më pak të zhvilluara përsa iu përket reformave të tranzicionit. Konings (2000) për shembull, krahason ecurinë e mirë të IHD-së në Poloni përkundrejt Bullgarisë apo Rumanisë, të dyja më pak të qëndrueshme politikisht dhe ekonomikisht. Përmirësimet në klimën e investimit për të ndihmuar tërheqjen e më shumë flukseve të IHD, do të përkthehen në krijimin e një kapitali të qëndrueshëm bruto më të lartë, i cili pastaj do të çojë në rritje më të lartë ekonomike. Kjo, sipas Krkoska (2001), është më e rëndësishme në vendet pa burime natyrore dhe në vende në tranzicion me asete të pakta shtetërore për t'u privatizuar.

Një tjetër tregues i rëndësishëm i aftësisë tërheqëse për të cilin ekonomitë në tranzicion si ato të Evropës Qendrore e Lindore kanë nevojë është një grup i besueshëm institucionesh shtetërore, me një paketë të qëndrueshme politikash fiskale e monetare. Shpeshtësia e ndryshimeve në politikat ligjore dhe pengesat burokratike e administrative të një vendi, ndikojnë fuqimisht në zgjedhjet për investim (OECD, 1994).


Politikat e investimeve të huaja mund të ndikojnë gjithashtu në tërheqjen ose pengimin e flukseve hyrëse të investimeve. Vendet në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore, të cilat ndjekin politika aktive kombëtare të IHD-ve, nxisin investimet e huaja përmes zbutjes së taksave, krijimit të zonave të lira ekonomike si dhe përmes parandalimit të tatimit të dyfishtë. Në vendet, të cilat ndjekin politika pasive që lidhen me investimet, IHD-të dekurajohen përmes kërkesës së lejeve dhe regjistrimeve shtesë të investimeve, si dhe kufizimeve dhe barrierave të ndryshme. Megjithatë, Dunning (1994, faqe 386) argumenton se:

"Çështja nuk është vetëm liberalizimi i politikave të investimit apo krijimi i stimujve fiskalë tejet bujarë për investitorët e huaj.

Njëkohësisht, në mos më e rëndësishme, është që qeveritë e vendeve përkatëse të krijojnë e mbështesin një mjedis ekonomik e shoqëror, ku firmat vendase dhe të huaja të mund të konkurrojnë në mënyrë efektive.”

2.6. TENDENCAT BOTËRORE TË IHD-SË

Si rrjedhim i një rritjeje të fortë të IHD-së hyrëse në vendet në zhvillim, flukset botërore të IHD-së rinisën të rriten në vitin 2004, pas tre vjetësh rënieje. Sipas World Investment Report 2005 (Raporti Botëror mbi Investimet) (UNCTAD, 2005), përqindja e flukseve hyrëse globale të investimeve të huaja direkte (IHD) në vendet në zhvillim, vijoi të rritet në vitin 2004 me 40 për qind, ndërkohë që IHD-të në vendet e zhvilluara u ulën me 14 për qind. Një rritje e tillë shënoi përqindjen më të madhe të IHD-ve për vendet në zhvillim, me 36 për qind që prej vitit 1997.



Vendet në zhvillim jo vetëm që po thithin një pjesë të madhe të flukseve hyrëse të IHD-ve, por ato njëkohësisht kanë filluar

të veprojnë në tregun ndërkombëtar si burime të investimeve të huaja dalëse. Tashmë, shoqëritë shumëkombëshe të vendeve në zhvillim po bëhen një faktor i rëndësishëm në tregun botëror të IHD-ve (UNCTAD, 2004a). Palmade dhe Anayiotas (2004, faqe 2) pohojnë se: “Fakti që vendet në zhvillim janë burime në rritje të flukseve dalëse të IHD-së është një lajm dyfish pozitiv, duke qenë se këta lojtarë të rinj kanë tendencë të jenë më shumë të gatshëm të investojnë në tregje më të largëta e më të vështira si dhe të ofrojnë prodhime e shërbime më të përshtatshme për konsumatorët e vendeve të tjera në zhvillim”. Në analizën e tyre ata vënë re se edhe sektorët ku përqendrohet IHD po bëhen gjithmonë e më të shumëllojshëm. IHD ka evoluar nga burimet natyrore, infrastruktura e industria e përpunimit ku fokusohej fillimisht, në mbulimin e sektorëve bankarë, të tregtisë, të ndërtimit, të turizmit etj..

“Prospect for Foreign Direct Investment” (Perspektivat për Investimet e Huaja Direkte) përgatitur nga UNCTAD (2004b) parashikon rritjen e mundshme të flukseve botërore të IHD-ve gjatë viteve 2005-2007. Megjithatë, parashikimet për të ardhmen e IHD-së varen nga një tërësi faktorësh mikro e makroekonomikë, e zhvillime politikash si ritmet e rritjes ekonomike; nivelet botërore të normave të interesit; investimet e brendshme dhe përpjekjet politike në nivele kombëtare e ndërkombëtare.

Edhe përsa iu përket vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, rezultatet e analizës së vrojtimit flasin për një të ardhme të shkëlqyer të IHD-ve, në periudhën afatmesme (2006-2007). Për shumë arsye flukset e IHD-së në BE – 8 (anëtarët e rinj të BE nga Evropa Qendrore e Lindore: Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Latvia, Lituania, Polonia, Sllovakia e Sllovenia) pritet të rriten në vitet e ardhshme. Tërheqshmëria e këtij rajoni si terren për investim të huaj direkt pritet të rritet me anëtarësimin në BE, meqenëse klima e biznesit është përmirësuar tani që këto vende kanë adoptuar plotësisht ligjet e BE-së (UNECE, 2005).

3. METODOLOGJIA

3.1. STRATEGJIA E KËRKIMIT

Qëllimi i përgjithshëm i këtij materiali është studimi i IHD-së në vendet më pak të zhvilluara, e në të njëjtën kohë në zhvillim, të Evropës Lindore, me një fokus të veçantë mbi Shqipërinë. Të dhënat statistikore tregojnë se IHD është shpërndarë në mënyrë të pabarabartë ndërmjet vendeve të marra në konsideratë. Qëllimi i këtij studimi është të shpjegojë faktorët e ndryshëm që përcaktojnë “sjelljen” si edhe efektet e IHD-së në këto vende dhe në tranzicionin e tyre në ekonominë e tregut.

Qëndrimi i përgjithshëm i mbajtur në këtë material për të adresuar objektivat e tij kryesorë, është i orientuar më shumë nga një kërkim cilësor. Kërkimi fillon me vëzhgime mbi fenomenin e IHD-së, bazuar në kërkime e materiale ekzistuese, dhe vijon me shpjegimin e modelit të sjelljes së tij. Gjithsesi, përgjatë tij, ky studim përfshin edhe elemente kërkimi sasiore, si analiza e të dhënave statistikore dhe përpjekje për të shpjeguar ecuritë e për të dhënë strategji të mundshme.

3.2. MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE MËNYRA E SHTJELLIMIT

Për të përmbushur objektivat e këtij projekti kërkimor, është ndërmarrë rishikimi i një literature të gjerë që fokusohet në shpjegimin e IHD-së dhe karakteristikave kryesore të tij. Ndërkohë, të dhënat dytësore të mbledhura kanë ndihmuar për të njohur e kuptuar çështjet kryesore dhe elementet-kyçe të lidhura me IHD. Burime të të dhënave dytësore përfshijnë: studime të mëparshme e raste studimi në këtë fushë, artikuj gazetash, raporte, konferenca e materiale pune, tabela statistikore, baza të dhënash në internet etj..

Materiali kërkon të shtjellojë lidhjen midis treguesve të tillë si IHD, PBB, PBB për frymë, numër banorësh, liberalizimi tregtar e politikat e jashtme etj.. Për vendet të Evropës Juglindore, flukset e IHD-së varen shumë nga përfundimi i procesit të privatizimit, për

rrjedhim privatizimi ka qenë një variabël i rëndësishëm i marrë në konsideratë për këto vende.

Të dhënat mbi flukset dhe stoqet e IHD-së janë marrë nga botime të ndryshme të Librit Vjetor të Statistikave të Investimit Ndërkombëtar të OECD-së dhe nga Libri Vjetor i Statistikave të Bilancit të Pagesave botuar nga FMN, e janë plotësuar me të dhëna kombëtare. Ndarja sipas vendeve të origjinës e sipas industrisë së investimeve, shpesh është bazuar në burime të ndryshme e mund të ketë një stok të ndryshëm IHD-je për bazë. Të dhënat për PBB, PBB për frymë, popullsinë e zhvillimin ekonomik, janë marrë nga baza e të dhënave statistikore e UNCTAD.

Të dhënat lidhur me Shqipërinë janë marrë nga institucione shqiptare si: Agjencia Shqiptare për Zhvillimin Ekonomik, Banka e Shqipërisë, Ministria e Ekonomisë, Agjencia për Nxitjen e Investimit të Huaj (ANIH) dhe Instituti i Statistikave (INSTAT).

3.3. KUFIZIMET DHE MËNYRA ALTERNATIVE TË KËRKIMIT

Megjithëse është punuar për të gjetur informacionin më të përditësuar të mundshëm, deri në momentin e punimit të këtij materiali (shtator, 2005), të dhënat e disponueshme datojnë në vitin 2004. Gjithashtu, mbulimi me të dhëna ndryshon midis shteteve duke qenë se shumë nga bankat qendrore të vendeve të analizuara, nuk janë akoma në pozicionin e duhur për të prodhuar të dhëna që përfshijnë të gjitha llojet e IHD-ve. Kjo është patur parasysh kur janë bërë vlerësime rajonale apo krahasime midis shteteve.

Ka disa arsye që çuan në zgjedhjen e kësaj metode kërkimi të bazuar në kërkim dytësor në vend të ndërmarrjes së pyetësorëve apo vrojtimeve, kur flitet për rastin e Shqipërisë.

Në rradhë të parë, objektivat e studimit fokusohen më shumë në ecurinë, përcaktuesit, efektet dhe strategjitë e IHD-së në Shqipëri në përgjithësi, më tepër se sa në ndonjë fushë në veçanti. Së dyti, për të arritur këta objektiva, të dhënat e siguruar nga burimet e

përmendura më sipër janë më të sakta e më të kujdesshme se sa ato që mund të mblidheshin me ndonjë mënyrë tjetër në Shqipëri.

Dhe së fundi, Shqipëria vazhdon të vuajë mungesën e transparencës për sa i përket statistikave dhe informacionit në përgjithësi. Ka përgjithësisht, pak kulturë të ofrimit të informacionit; si rrjedhim të marrësh përgjigje për vrojtimet apo intervistimet është relativisht e vështirë.

4. REZULTATET E KËRKIMIT DHE ANALIZA

4.1. VENDET DHE SFONDI HISTORIK

Sipas fjalorit të politikave moderne (Robertson, 1993), deri në rënien e pushtetit sovjetik, Evropa Lindore përkufizohej politikisht dhe jo gjeografikisht. Ajo përbëhej kryesisht nga ato vende, të cilat pas Luftës së Dytë Botërore ranë nën regjimin komunist (Shqipëria, Bullgaria, Çekosllovakia, Gjermania Lindore, Hungaria, Polonia, Rumania dhe Jugosllavia). Edhe pas pesëmbëdhjetë vitesh nga rënia e regjimit komunist, në studime dhe materiale diskutimi Evropa ende përshkruhet me të njëjtat ndarje gjeografike si në kohën e Luftës së Ftohtë. Shpesh, vendet me ekonomi në tranzicion të Evropës Lindore ndahen në dy grupe: vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (Central Eastern European - CEE), të cilat (pa përfshirë shtetet balltike) përbëhen nga: Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Republika Sllovaqe dhe nga Sllovenia; dhe vendet e Evropës Juglindore (South Eastern European - SEE), të cilat përfshijnë: Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Rumaninë, Serbinë dhe Malin e Zi. Ky kërkim i referohet klasifikimit të fundit.

“Vitet 1989 dhe 1990 ishin ndoshta më dramatike në historinë e Evropës së Pasluftës, duke dëshmuar fundin e Luftës së Ftohtë dhe liberalizimin e Evropës Qendrore e Lindore” (Buckley dhe Ghauri, 1994).

Trashëgimia komuniste në Evropën Lindore dallohej për dy aspekte të rëndësishme. Së pari, struktura e pronësisë socialiste

e vendosi industrinë, shërbimet dhe bujqësinë kryesisht në duart e shtetit. Së dyti, pas dyzet viteve, sistemi ekonomik komunist nuk arriti të mbajë veten e tij, duke lënë pas një kolaps të thellë industrial, kaos dhe gjendje të vështirë financiare, si dhe standarde shumë të ulëta jetese.

Shtetet e të dyja grupeve (SEE e CEE) janë përgjithësisht të vogla ose të mesme në përmasa, me përjashtim të Polonisë e Rumanisë. Megjithatë, treguesit e zhvillimit të tyre në fillim të tranzicionit ishin shumë të ndryshëm. Vendet e CEE kishin standarde më të larta e tregues ekonomikë më të mirë: prodhimi i brendshëm bruto për frymë në vendet e CEE në vitin 1992 ishte mesatarisht 3,566 dollarë amerikanë, krahasuar me 1,363 dollarë amerikanë që ishte në vendet e SEE.

Tabelë 1. Popullsia, sipërfaqja dhe PBB në vendet e SEE dhe CEE në vitin 1992.

	TREGUESI	Popullësia	Sipërfaqja	Dendësia	PBB	PBB për frymë
	Shteti \ njësia	(në mijë)	(kilometra katrore)	(banore për km.katrore)	(milionë USD)	(USD)
CEE	Republika Çeke	10,318.86	78,866	130.84	32,240	3,124.37
	Hungaria	10,300.89	93,032	110.72	37,604	3,650.56
	Polonia	38,352.07	323,250	118.65	87,852	2,290.67
	Slllovenia	5,303.94	49,012	108.22	12,382	2,334.49
	Slllovakia	1,947.88	20,250	96.19	12,523	6,429.04
	Shqipëria	3,284.12	28,748	114.24	676	205.84
SEE	Bosnja dhe Hecergovina	3,952.44	51,197	77.20	1,387	350.92
	Bullgaria	8,593.99	110,912	77.48	8,604	1,001.16
	Kroacia	4,729.82	56,538	83.66	10,241	2,165.20
	Maqedonia	1,933.46	25,713	75.19	2,317	1,198.37
	Rumania	23,059.35	238,391	96.73	19,578	849.03
	Serbia e Mali i Zi	10,320.05	102,173	101.08	38,925	3,768.86

Burimi: Baza e të dhënave UNCTAD (Handbook of Statistics on-line).

Kalimi nga ekonomi të centralizuara në ekonomi tregu filloi së pari në Poloni dhe Hungari, të cilat ishin vendet e para që prekën demokracinë dhe të parat që përfituan nga përfshirja e komunitetit ndërkombëtar në procesin e tyre të tranzicionit përmes asistencës dhe ekspertizës (Lavigne, 1995). Si rrjedhim zhvillimi e progresi


ishin më të shpejtë e më të dukshëm në shtetet e CEE. Nga ana tjetër, Evropa Juglindore ka qenë rajoni më pak i zhvilluar në Evropë. Ekonomitë në rajon filluan procesin e tranzicionit nga një gjendje tejte e vështirë; pasiguria politike ishte në nivele të larta, institucionet e dobëta dhe shoqëritë civile të copëtuara. Ecuria makroekonomike ishte mjaft e paqëndrueshme, ndikuar thellë nga konfliktet dhe luftrat civile gjatë pjesës më të madhe të periudhës së tranzicionit.

Hunya (2004) shpjegon se Evropa Juglindore është një rajon i variueshëm si politikisht ashtu edhe në terma zhvillimi. Disa nga këto vende në tranzicion janë shumë komplekse edhe në këndvështrimin konstitucional. Kështu, Bosnja dhe Hecergovina përbëhen nga një republikë (Republika Srsпка) dhe një federatë (Federata e Bosnjes dhe Hecergovinës). Serbia dhe Mali i Zi është një bashkim i dy shteteve, dhe Serbia ka një provincë – Kosovën, që është nën mbrojtjen ndërkombëtare (Hunya, 2004).

Vendet e SEE janë përgjithësisht më pak të zhvilluara. Këto vende kanë marrëdhënie më pak të ngushta me BE-në dhe mbeten prapa vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore përse i përket progresit të arritur gjatë fazës së tranzicionit. Ato kanë një sektor privat jo shumë të zhvilluar dhe sektor publik jo të reformuar sa duhet. Për t'u përmendur janë edhe ekonomia informale dhe problemet me zbatimin e ligjeve. Zhvillimet e dekadës së fundit kanë treguar se vendet më demokrate e më të liberalizuara kanë ecur më mirë se vendet e SEE, që kanë akoma probleme në të dyja drejtimet (Hunya, 2004).

Pavarësisht nga kjo, Ballkani po ngushton këtë hendek në mënyrë të dukshme. Rajoni i Evropës Juglindore llogaritet në pak më shumë se 2 për qind të prodhimit botëror të brendshëm bruto, sipas paritetit të fuqisë blerëse, e pothuaj me po të njëjtën përqindje në popullsinë botërore. Megjithatë, pavarësisht nga ngadalësimi i përgjithshëm botëror, ky rajon mbetet një nga rajonet me rritjen më të konsiderueshme të PBB-së, duke lënë pas rritjen botërore dhe të BE-së nga viti 1999 deri në vitin 2004. Në rajonin e Evropës Juglindore, Shqipëria e cila ngrihet prej nivelit më të ulët, pati normën më të lartë të rritjes, e ndjekur nga kandidatet për hyrje në Bashkimin Evropian Rumania, Bullgaria e Kroacia.

Grafik 2. Norma mesatare rajonale e rritjes së PBB-së (2000-2004), (në milionë usd).




4.2. ZHVILIMI I IHD-VE NË RAJON

Gjatë viteve 1990 – 2004, vendet e Evropës Juglindore, si grup, kanë tërhequr shumë më pak IHD sesa vendet në tranzicion të Evropës Qendrore. Diferenca midis dy grupeve bëhet e qartë kur krahason nivelit e stokut të IHD-së në fund të vitit 2004. Edhe brenda grupit të vendeve të SEE ka diferencime të konsiderueshme, me Rumaninë dhe Kroacinë që tërheqin pjesën më të madhe të IHD-së. Shqipëria, Bosnja dhe Hecergovina, dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë janë pothuajse në të njëjtin nivel, me ecurinë më të dobët në rajon përsa i përket IHD-së.

Megjithatë, duket se vendet e Evropës Juglindore po i afrohen niveleve të fqinjëve të tyre. Flukset hyrëse të IHD-ve në Evropën Juglindore filluan të rriten pas vitit 2002. Ndikuar nga procesi i privatizimit, këto flukse hyrëse pothuajse u trefishuan, duke arritur në vitin 2004, në 11 miliardë usd.


Grafik 3. Totali i stokut të IHD-së, viti 2004 (në milionë dollarë).



Burimi: Baza e të dhënave të UNCTAD (statistikat on-line të IHD-së).

Brenda grupit të vendeve të Evropës Juglindore, Rumania, Kroacia dhe Bullgaria mbeten aktorët kryesorë në tërheqjen e flukseve të IHD-ve. Në fund të vitit 2004, ato thithën pjesën më të madhe të


Grafik 4. Flukset hyrëse rajonale të IHD-ve, 1992-2004 (në milionë dollarë).



Burimi: Baza e të dhënave të UNCTAD (statistikat on-line të IHD-së).

totalit të stokut të IHD-ve në Ballkan, duke i lënë vendet më pak të zhvilluara si Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi me një total prej më pak se 20 për qind të stokut të IHD-ve. Megjithatë, gjatë katër viteve të fundit, në këto vende është vënë re tendenca rritëse e flukseve hyrëse të IHD-ve.

Grafik 5. Stoku i IHD-ve sipas vendeve pritëse në Evropën Juglindore, viti 2004.



Burimi: Baza e të dhënave të UNCTAD (statistikat on-line të IHD-se).
Shënim: Shiko aneksin 1 për shkurtimeve e emrave të shteteve.

Hunya (2004) shpjegon tendencat e ndryshme të IHD-ve sipas natyrës së flukseve hyrëse të tyre. Në Evropën Qendrore, IHD-të nga procesi i privatizimit, në parim kanë përfunduar dhe tregu vendor kontrollon nga investitorët e huaj, të cilët kryesisht investojnë në projekte të orientuara drejt eksporteve, në kompani ekzistuese ose në impiante të reja. Tregu kryesor i eksporteve, grupi i BE-15, nuk është zgjeruar gjatë viteve të fundit dhe veprimtaria e përgjithshme e investimeve të ndërmarrjeve shumëkombëshe ka qenë e ulët.

Ndërkohë, në vendet e Evropës Juglindore, IHD-të kanë ndjekur një model të ndryshëm. Niveli i mëparshëm i ulët i IHD-së ishte në pjesën më të madhe rrjedhojë e rrezikut të lartë të investimit të lidhur me konfliktet, qeverisjes së dobët si dhe faktorëve të tjerë bazë të rrezikut. Progresi i arritur gjatë viteve të fundit në transformimin ekonomik është përkthyer në rrezik më të ulët në

investim dhe rritje të interesit nga ana e investitorëve të huaj. Vëllimet në rritje të IHD-ve në rajon kanë ardhur dhe si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të qeverive përkatëse për privatizimin e kompanive të mëdha, shërbimeve publike dhe bankave, ndonëse ato rrallëherë kanë shkuar në drejtim të projekteve të orientuara drejt eksporteve.

Demekas et al (2005) vërejnë se IHD-të e lidhura me privatizimin janë një rast i veçantë, që nuk përcaktohen (ose nuk influencohen njësoj) nga të njëjtët variabla si IHD-të “tipike”. Pasi analizuan IHD-të në Evropën Juglindore për periudhën 1990 – 2003, ata sugjerojnë që natyra e IHD-së ndryshon, ndërkohë që vendi pritës tërheq më shumë investime. Vala fillestare e investitorëve tërhiqet kryesisht nga përmasat e tregjeve, lehtësia e hyrjes në to dhe kostoja e krahut të punës; por kur është arritur një “nivel kritik” investimi të huaj, vihet re një tip i ri investitori, i cili tërhiqet më shumë nga shkalla e zhvillimit institucional, cilësia e mjedisit të biznesit dhe mirëqenia e vendit. Kur krahasojnë IHD-të – jo të lidhura me privatizimin në terma aktualë dhe potencialë, Demekas et al (2005) dalin në përfundimin se vendet e Evropës Juglindore mund të shpresojnë të tërheqin një nivel të mirë shtese IHD-je, qoftë për të përmirësuar politikatat e tyre.

“Ndër këto vende, Bosnje dhe Hecergovina, Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia e Mali i Zi duket se do të përfitojnë më shumë në formën e IHD-ve shtesë nga përmirësimi i politikave të tyre të veprimit. Ky marzh është më i vogël për Rumaninë e Bullgarinë, të cilat kanë tërhequr ndërkohë nivele të konsiderueshme IHD-sh” (Demekas et al, 2005, faqe 25).

4.3. SEKTORËT, VENDET E ORIGJINËS DHE NXITJET PËR IHD-TË NË RAJON

Përsa i përket shpërndarjes së IHD-ve sipas sektorëve të ekonomisë, pjesa më e madhe e tyre në vendet e Evropës Juglindore përqendrohen në industrinë përpunuese, shërbimet financiare, telekomunikacion dhe tregti. Analiza e të dhënave nga BERZH (2004), ndërsa tregon se IHD-të në SEE përqendrohen në sektorin e industrisë së përpunimit, sugjeron që ndërmarrjet përpunuese

në vendet fqinje të BE, si Italia dhe Gjermania, po i zhvendosin aktivitetet e tyre të prodhimit industrial drejt lindjes, për të përfituar përparësitë e kostos krahasimisht më të lirë të krahut të punës. Në sektorin e industrisë përpunuese një nga industritë ku ka hyrë më shumë investimi i huaj në rajon, është prodhimi i çelikut. (Bevan dhe Estrin, 2000; Hunya, 2004.)

Sektori financiar është një sektor tjetër i rëndësishëm në Evropën Juglindore, ku përfshirja e investimeve të huaja është rritur ndjeshëm gjatë viteve '90. Privatizimi i gjithë sektorit bankar të këtyre vendeve është kryer gjatë viteve të fundit. Sipas Bevan dhe Estrin (2000), në fund të dekadës, bankat e huaja në Evropën Qendrore e Lindore përbënin rreth 70 për qind të bankave.

Sektori i turizmit ka tërhequr mjaft investime të huaja në Kroaci dhe Bullgari. Të dhënat tregojnë gjithashtu, që ka pak ose nuk ka fare investim të huaj në sektorin e agrikulturës, megjithëse ky sektor përbën një pjesë të mirë të PBB-së në shumicën e vendeve të SEE. Ndërkohë, mungesa e rristurimit, pasiguria lidhur me të drejtat pronësore dhe infrastruktura e dobët, janë ndër pengesat kryesore të investimeve të huaja në këtë sektor (BERZH, 2004).

Përsa i përket vendeve të origjinës për IHD-të, si vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore ashtu dhe ato të Evropës Juglindore, kanë tërhequr më së shumti fqinjët e tyre evropianoperëndimorë. Burimi kryesor i IHD-ve në rajon kanë qenë vendet e OECD-së, të cilat përbëjnë mbi 90 për qind të flukseve hyrëse të IHD-ve në Bullgari, Kroaci dhe Rumani (Broadman et al, 2004). Analiza gjeografike dhe sektorale kryer nga BERZH (2004) gjithashtu, tregon se pjesa më e madhe e IHD-ve vjen nga vendet e BE-së, si Italia, Gjermania, Austria dhe Greqia, me orientim veçanërisht drejt Rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Në lidhje me mjedisin e politikës në mbështetjen e IHD-ve, vendet e Evropës Juglindore kanë deri-diku një tregti të liberalizuar. Shqipëria, Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë janë tashmë anëtare të OBT-së, ndërkohë që Bosnje dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi janë në procesin e anëtarësimit. Për më tepër, sipas Komisionit Evropian (2004), pesë shtetet e lartpërmendura

gëzojnë hyrje pa doganë në tregun e BE-së, në sajë të Masave Asimetrike të Tregtisë, dhënë që prej fundit të vitit 2000.

Në aspektin e kuadrit rregullativ, të gjitha vendet e rajonit kanë legjislacionin e duhur të IHD-ve (në rastin e Bosnjë dhe Hercegovinës që prej vitit 1998). Në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë e Kroaci janë krijuar Agjenci për Nxitjen e Investimeve të Huaja, ndërkohë që në të gjitha vendet e Evropës Juglindore janë ngritur Zona të Lira të brendshme Tregtare, të cilat iu ofrojnë investitorëve të huaj mjaft mundësi. Në këto vende, ekzistojnë kufizime që lidhen me pronësinë e huaj, në sektorë të ndjeshëm, si pronësia mbi tokën (për shembull, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë) ose pronësia mbi tokën bujqësore (për shembull, në Shqipëri dhe Kroaci) (Komisioni Evropian, 2004).

“Ndërkohë që flukset hyrëse në SEE të lidhura me privatizimin apo ato zyrtare, parashikohet të bien në të ardhmen, sfida kryesore mbetet krijimi i bazave për të tërhequr kapitalet private të huaja, mundësisht në formën e IHD-së në ndërmarrje të reja. Kalimi i kësaj sfide me sukses nga ky rajon varet nga një sërë faktorësh, përfshirë edhe qëndrueshmërinë politike” (EBRD, 2004, faqe 10).

4.4. NDIKIMI I IHD-SË NË CEE DHE SEE

Shumë autorë argumentojnë se lidhja midis flukseve hyrëse të IHD dhe rritjes ekonomike, nuk është shumë e qartë dhe se rezultatet mbi ndikimin e IHD në rritjen e ekonomike janë të dyshimta.

Së pari, duket se janë flukset hyrëse të IHD-së më shumë të tërhequra nga rritja ekonomike se sa merr nxitje rritja ekonomike nga flukset hyrëse më të larta të IHD-së. Ky konkluzion bazohet në faktin se rreth tre të katërtat e flukseve hyrëse vjetore të IHD botërore, janë të investuara në vendet e zhvilluara. Megjithatë, e gjitha kjo mund të interpretohet si një “cikël virtual”: rritja ekonomike ofron një mjedis të përshtatshëm për hyrjen e IHD, e cila nga ana tjetër promovon raundin tjetër të rritjes ekonomike. Duke ndjekur këtë logjikë dhe duke marrë parasysh zhvillimet më të fundit ekonomike në vendet e SEE, e ardhmja do të sjellë rritje të niveleve të IHD në këto vende.

Së dyti, në literaturë argumentohet se IHD-të mund të kenë patur edhe disa ndikime negative për vendet në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore. Pavlinek (2004) ka pasqyruar një tablo të përgjithshme të ndikimeve të IHD në ekonomitë e vendeve të Evropës Qendrore e Lindore. Debati qëndron mbi faktin se ndërkohë që IHD-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritje, efektet e tyre kanë qenë shumë të çrregullta si në aspektin sektorial ashtu dhe gjeografik, dhe se evidenca deri më sot nuk mbështet një këndvështrim shumë pozitiv për IHD-të në rolin e tyre përgjatë transformimit ekonomik në periudhën postkomuniste.

“Duke nxituar drejt IHD-së si një zgjidhje efikase dhe e shpejtë për ekonomitë e Evropës Qendrore, në më të shumtën e rasteve është anashkaluar fakti se IHD potencialisht kanë efekte pozitive dhe negative në zhvillimet rajonale të ekonomisë, varur nga lloji i aktivitetit ekonomik dhe strategjia e ndjekur nga ndërmarrje shumëkombëshe të ndryshme, në varësi të kushteve të ndryshme vendase dhe rajonale” (Pavlinek, 2004, faqe 63).

Pavlinek (2004) ka evidentuar si një efekt potencialisht negativ të IHD, faktin se ekonomitë e vendeve të Evropës, gjithmonë e më shumë të varura nga IHD-të (që në më të shumtën e rasteve shkojnë drejt vendeve që ofrojnë kosto të ulët), janë edhe gjithmonë e më shumë të ndjeshme ndaj mbylljes së fabrikave, nëse monedha vendase pëson një mbivlerësim të shpejtë ose pagat vendase rriten ndjeshëm.

Megjithatë, nuk mund të mohet se flukset e mëdha hyrëse të IHD, sidomos në vendet e CEE, kanë kontribuar pa dyshim në ristrukturimin e këtyre ekonomive, duke i dhënë një nxitje aktivitetit ekonomik. Në këtë studim ndikimi i IHD-së në rritjen ekonomike është hulumtuar duke analizuar thjesht korrelacionin midis flukseve të IHD-së dhe të dhënave të PBB-së, për 12 vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për periudhën 1992- 2004. Duke marrë parasysh se pjesa më e madhe IHD që hyjnë në këto vende vjen nëpërmjet procesit të privatizimit (që do të thotë se IHD mund të mos kenë një ndikim të menjëhershëm në ekonominë pritëse), të dhënat janë analizuar edhe të ndërlidhura më një kohëvonesë prej 1 viti dhe më pas për 2 vjet.


Tabelë 2. Lidhja mes IHD-së dhe PBB-së me 1 dhe 2 vjet vonesë.

Viti (t)	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003
Korr. IHDt - PBBt	0.580	0.768	0.967	0.718	0.890	0.860	0.934	0.886	0.962	0.821	0.565	0.915
Korr. IHDt - PBBt+1	0.636	0.752	0.942	0.712	0.892	0.851	0.934	0.976	0.962	0.854	0.599	...
Korr. IHDt - PBBt+2	0.621	0.702	0.946	0.708	0.883	0.860	0.931	0.876	0.968	0.878
Flukset e IHD (milion USD)	3,648	5,419	4,990	12,488	10,759	13,995	18,660	21,092	22,769	21,716	25,314	16,744

Gjithsesi, në të gjitha rastet vlerat janë shumë pranë vlerës 1 në pjesën më të madhe të kohës. Një fakt i tillë dëshmon për një lidhje të fortë midis variablave, dhe që IHD kanë qenë një promovues i rritjes ekonomike në këto vende. Nëse ne do të kontrollonim lidhjen midis variablave në vende të ndryshme për të gjitha vitet, rezultatet janë disi më ndryshe dhe lidhja nuk duket të ketë të njëjtën rëndësi statistikore për të gjitha vendet.

Tabelë 3. Lidhja mes IHD-së dhe PBB-së për çdo shtet.

Shtetet (gjatë 12 viteve)	RÇEKE	HUN	POL	SLO	SLLV	SHQ	BH	BUL	KRC	MAQ	RUM	SMZ
Korelacioni: HDt - PBBt	0.77	0.02	0.66	0.33	0.28	0.81	0.88	0.84	0.77	0.03	0.77	0.06



Vendet që tregojnë vlera të veçuara nga e përgjithshmja janë Hungaria, Maqedonia dhe Serbia e Mali i Zi. Arsyeja për veçimin e këtyre vendeve është fakti që siç tregojnë të dhënat, në to ka pasur një sjellje jo të qëndrueshme të PBB-së ose IHD-së, ose të të dyjave bashkë, sikurse vihet re edhe në grafikët e mëposhtëm. (Për më shumë detaje shiko aneksin 2: Lidhja midis IHD-së dhe PBB-së.)

4.5. SHQIPËRIA

4.5.1. Sfondi dhe Zhvillimi Ekonomik

Shqipëria ndodhet në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, në një sipërfaqe prej 28,748 kilometra katrorë. Ajo ndan kufirin me Malin e Zi dhe Kosovën në veri e verilindje, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në lindje dhe Greqinë në jug. Në perëndim, Italia është fqinja më e afërt, rreth 82 kilometra përmes detit Adriatik nëpër Kanalin e Otrantos. Popullsia totale është rreth 3.2 milionë banorë, rreth 98 për qind e të cilëve janë shqiptarë etnikë.


Fillimi i viteve 1990 për vendin ishte fundi i pothuaj një gjysmë shekulli nën qeverisjen shtypëse komuniste. Nga ai regjim, Shqipëria trashëgoi varfëri, një sektor industrial të paefektshëm dhe mungesa të theksuara në institucionet e administratës. Impakti i parë i tranzicionit për në ekonominë e tregut, shkaktoi shumë probleme makroekonomike. Gjatë viteve 1991-1992, PBB-ja ra me 40 për qind, inflacioni arriti nivelin 226 për qind dhe norma e papunësisë u rrit në 27.9 për qind (KPMG, 2003).

Reforma e plotë stabilizuese dhe strukturore filloi të zbatohet në mes të vitit 1992, me asistencën e organizatave ndërkombëtare, veçanërisht të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Programi i stabilizimit u mbështet në paketën standarde që konsiston në liberalizimin e çmimeve, në politikën fiskale që synonte balancimin e deficitit buxhetor, në politikën shtrënguese monetare nëpërmjet kontrollit të rritjes së ofertës monetare dhe në liberalizimin e tregtisë së jashtme, duke siguruar konvertibilitetin e llogarisë korente. Paralelisht me paketën stabilizuese u ndërmorën reforma strukturore me privatizimin, rrjetin e mbrojtjes sociale, në

sistemin e taksave dhe në atë financiar e bankar dhe me krijimin e kuadrit ligjor për një ekonomi tregu (FMN, 1994). Rezultatet ishin të dukshme: Shqipëria provoi një ecuri makroekonomike stabël, me një rritje mesatare ekonomike prej 9 për qind në vit si dhe ulje të inflacionit nga 226 për qind në vitin 1992, në 4.2 për qind në vitin 2000 (Kule dhe Hadëri, 2001).

Megjithatë, progresi ekonomik nuk u mbështet nga reforma institucionale. Institucionet shtetërore mbetën të dobëta dhe sektori financiar nuk u zhvillua mjaftueshëm. Në vitin 1997 vendi hyri në një periudhë paqëndrueshmërie ekstreme, që erdhi si pasojë e përmbysjes së skemave piramidale. Kriza ekonomike dhe politike çoi në rënie të prodhimit në masën 7 për qind, në rritje të inflacionit në masën 45 për qind dhe në përkeqësim të llogarisë korente dhe të deficitit fiskal (Kule dhe Hadëri, 2001). Qeveria e re e mesvitit 1997 zbatoi një program paskrizë, të mbështetur edhe nga donatorët ndërkombëtarë si edhe thelloi më tej reformat strukturore, veçanërisht në fushën e privatizimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha si edhe të atyre strategjike.

Grafik 7. Normat e rritjes së PBB-së për vendet e SEE, 2000-2004.



Burimi: Baza e të dhënave të UNCTAD (statistikat on-line të IHD-së).
Shënim: Shiko aneksin 1 për shkurtime të emrave të shteteve.

Sipas raportit të fundit të FMN-së (2005), ecuria e përgjithshme makroekonomike e ekonomisë shqiptare që nga viti 1997 ka qenë e mirë. Pas një ngadalësimi në vitin 2002, rritja ekonomike e mori përsëri veten në ritmet rreth 6 për qind; inflacioni ka rënë me një normë vjetore që ka mbetur brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë 2-4 për qind. Në katër vitet e fundit Shqipëria ka ruajtur ritme të rritjes ekonomike ndër më të lartat në rajon.


Monedha shqiptare (Lek) ka treguar një tendencë mbivlerësimi duke reflektuar rritje të besimit; deficitit tregtar dhe ai korent, megjithëse në vlera akoma të larta, janë përmirësuar. Kjo ecuri është e mbështetur nga politika të shëndetshme në sektorin monetar e financiar, konsolidimi fiskal, privatizimi si dhe reforma strukturore në fusha të veçanta. Ekspansioni i ekonomisë së tregut dhe regjimi i tregtisë së lirë kanë gjeneruar rritje të produktivitetit nëpërmjet rishpërndarjes së burimeve që nga fillimi i tranzicionit (sektori privat tashmë përbën rreth tre të katërtat e PBB-së) (FMN, 2005).

Sektori bankar në Shqipëri është ndër më pak të zhvilluarit në rajon, megjithatë ai është vërtet në zhvillim. Në vitin 2005 kishte gjashtëmbëdhjetë banka private, ndërkohë që shtatë vjet më parë kishte vetëm 4 banka të tilla. Banka e Shqipërisë është një institucion i fortë e i dedikuar të promovojë sigurinë dhe mbarëvajtjen e sektorit bankar.

4.5.2. Zhvillimi i IHD-ve në Shqipëri

Flukset e IHD-ve vazhdojnë të jenë një përbërës i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit privat dhe një kusht për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Edhe nga pikëpamja e bilancit të pagesave, këto flukse kanë qenë faktorë dominues të ecurisë së llogarisë kapitale e financiare. Gjatë viteve të fundit, në krahasim me burimet e tjera, si për shembull borxhi i jashtëm, flukset e IHD-ve kanë qenë një burim i rëndësishëm i kapitalit të huaj për financimin e deficitit korent të Shqipërisë. Ekonomia e Shqipërisë është bërë mjaft e hapur ndaj investimeve të huaja vitet e fundit. Nivelet e investimeve të huaja në Shqipëri kanë pësuar luhatje në këtë periudhë. Megjithatë,


Grafik 8. Financimi i deficitit korent nga IHD, 1996-2004.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Buletini i Bilancit të Pagesave 2004.

ato mbeten përgjithësisht nën standardet rajonale, veçanërisht në krahasim me vendet e Evropës Juglindore, të cilat gjithashtu filluan nga niveli zero i IHD-ve në vitin 1990 dhe me pothuajse të njëjtat

Grafik 9. Fluksi i IHD-ve në Shqipëri në krahasim me mesataren e vendeve të Evropës Juglindore, 1992-2004 (në milionë dollarë).



Burimi: Baza e të dhënave e UNCTAD (FDI on – line), Banka e Shqipërisë.

kushte politike dhe ekonomike. Duke parë shifrat e flukseve të IHD-ve gjatë viteve të tranzicionit, është e qartë se që prej fillimit të tij e deri në vitin 1996, ka patur një tendencë rritëse të kapitalit të huaj në Shqipëri.

Vlen të theksohet se gjatë viteve 1995-1996, skemat piramidale ishin në boom-in e tyre dhe një faktor i tillë duket të ketë ndikuar mjaft në investimet e huaja. Menjëherë pas krizës së vitit 1997, investimet e huaja u ulën me 50 për qind, në krahasim me ecurinë e tyre më të mirë gjatë viteve 1995-1996. Imazhi i Shqipërisë pas kaosit institucional dhe shoqëror kishte mjaft për të rifituar. Kriza e Kosovës në vitin 1999 ishte një faktor tjetër (megjithëse rajonal, duke qenë se shkaktoi një rënie të flukseve të IHD-ve në mbarë rajonin), i cili pati një ndikim të madh në uljen e investimeve të huaja.

Kjo analizë e thjeshtë tregon se vështirësitë e Shqipërisë në ruajtjen e imazhit të një mjedisi të qëndrueshëm politik, kanë qenë një pengesë e madhe për shumë investitorë të huaj (për të cilët stabiliteti politik, që kryesisht nënkupton stabilitetin institucional, është parakushti kryesor për investimet) që të investojnë në Shqipëri. Paqëndrueshmëria dhe mungesa e zbatimit të ligjit, brenda vendit ose në nivel rajonal, kanë qenë barriera kryesore për investimet e huaja direkte në Shqipëri, pasi përsa i përket nivelit të liberalizimit të ekonomisë dhe kuadrit të duhur ligjor, Shqipëria ka bërë një përparim të ndjeshëm. Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme kur institucionet janë të dobëta dhe të paqarta në rolin e tyre. Gjatë këtyre viteve, privatizimet kanë luajtur rolin kryesor në rritjen e flukseve të IHD-ve. Një shembull i kësaj rritjeje ishte privatizimi i bankës më të madhe tregtare, Banka e Kursimeve në Shqipëri. Në mesin e muajit prill 2004, Austrian Raiffeisen Zentralbank (RZB) bleu 100 për qind të aksioneve në vlerën 126 milionë dollarë, që përfaqësonte 37 për qind të totalit të fluksit vjetor të IHD-ve për vitin 2004.


Deri në fund të vitit 2004 u privatizuan pothuajse të gjitha ndërmarjet e vogla dhe të mesme shtetërore. Qeveria tani po punon për privatizimin e objekteve të tjera strategjike, siç janë AlbTelekomi (ofruesi i vetëm i shërbimit të telefonisë fikse në Shqipëri) dhe KESH-i (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

Një grup i përbashkët pune i krijuar me pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë, Institutit të Statistikave dhe Ministrisë së Ekonomisë, ndërmori në muajin nëntor 2004, një vërtetim mbi IHD-të. Qëllimi i këtij vërtetimi qëndron në evidentimin e investimeve të huaja në Shqipëri, nëpërmjet anketimit në shkallë kombëtare të kompanive me kapital të huaj dhe të përbashkët që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri. Të dhënat e mbledhura reflektojnë aktivitetin e IHD-ve në Shqipëri gjatë periudhës 1998 – 2003 dhe bazohen në përgjigjet e 760 kompanive. Në më shumë se 62 për qind të kompanive që iu përgjigjën vërtimit, investitori i huaj zotëron 70 – 100 për qind të kapitalit të kompanisë.

Sipas analizës së vërtimit, pothuajse 70 për qind e IHD-së në Shqipëri vjen nga Bashkimi Evropian. Në terma të shpërndarjes gjeografike, struktura e kapitalit të huaj në formën IHD-ve mbizotërohet nga kapitali grek (në masën 35 për qind) dhe ai italian (në masën 21 për qind).

Rritja e stokut të kapitalit të huaj në vite vërehet të ketë qenë më e ndjeshme përse i përket kapitalit grek. Në fund të vitit 2003 ky vlerësohej në rreth 161 milionë usd nga 23 milionë usd i vlerësuar


Grafik 10. Stoku i IHD-së sipas vendeve të prejardhjes (2003).



Burimi: Vërtetimi për IHD në Shqipëri, Banka e Shqipërisë, INSTAT, Ministria e Ekonomisë.


në vitin 1998 (grafik 12). Kapitali grek është i përqendruar kryesisht në sektorin bankar, në masën 47 për qind (për vitin 2003) dhe në komunikacion, në masën 42 për qind.

Grafik 11. Ecuria e stokut të kapitalit të huaj sipas shteteve, (në milionë usd).



Burimi: Vrojtimi për IHD në Shqipëri, Banka e Shqipërisë, INSTAT, Ministria e Ekonomisë.

Grafik 12. IHD sipas sektorëve të ekonomisë.



Burimi: Vrojtimi për IHD në Shqipëri, Banka e Shqipërisë, INSTAT, Ministria e Ekonomisë.

Kapitali italian për periudhën e vrojtuar (1998-2003) ka ruajtur përfaqësimin e tij në nivele rreth intervaleve 60-65 për qind, me investime në industrinë përpunuese. Në fund të vitit 2003 stoku i kapitalit italian vlerësohet në rreth 97 milionë usd nga 51 milionë usd në vitin 1998.

Në terma të shpërndarjes sektoriale të IHD-ve shihet qartë përqendrimi i kapitalit të huaj në sektorët joindustrialë dhe në ata me vlerë të shtuar të ulët e me përdorim intensiv të fuqisë punëtore, gjë që reflektohet edhe në përqendrimin e punësimin.

Pjesa më e madhe e tyre ka për destinacion sektorin e ndërmjetësimin monetar dhe financiar, i cili përfaqëson rreth 52 për qind (në vitin 2003) të totalit të IHD-ve. Pasardhës është sektori i industrisë përpunuese me rreth 24 për qind. Në sektorin përpunues, më shumë se 62 për qind e IHD-ve është me destinacion në industritë përpunuese që përdorin krahun e punës (për shembull, tekstile dhe veshje, përpunim ushqimor, fabrikimi i mobilieve). Industritë përpunuese me përdorim të teknologjisë (për shembull, mjekësore dhe farmaceutike, makineri e pajisje elektrike dhe elektronika) dhe ato me përdorim të kapitalit (për shembull, rafineri nafte, materiale kimike) thuajse ndajnë pjesën e mbetur. Kjo shpërndarje sugjeron që një motivim i rëndësishëm për kompanitë e huaja ka qenë përparësia e fuqisë së lirë punëtore dhe nga ana tjetër, rrjedhjet (spillovers) teknologjike nuk kanë patur një ndikim të madh në industrinë e vendit.

Përsa i përket përqendrimit gjeografik brenda territorit të Shqipërisë, vihet re që IHD-të janë përqendruar kryesisht në distriktet kryesore të Shqipërisë, ku Tirana dhe Durrësi zënë rreth 76 për qind të totalit të kompanive me kapital të huaj dhe të përbashkët. Ka më pak ose mungesë totale investimi në qytetet e tjera, që mund të ofrojnë mundësi investimi (për shembull, qytetet bregdetare të cilat janë burime potenciale për industrinë e turizmit).

4.5.3. Klima e investimit

Komisioni Evropian (2004) ofron një seri treguesish mbi “mjedisin e investimit” dhe i analizon ato vend për vend, me qëllim

që të vlerësojë situatën në vendet e Ballkanit, veçanërisht në ato të Ballkanit Perëndimor. Rezultatet e regjistruara në tabelën e mëposhtme janë marrë nga një vërtetim i Bankës Botërore mbi një zgjedhje prej 133 vendesh, që përfshijnë vende të zhvilluara e në zhvillim.

Tabelë 3. Treguesit e mjedisit të biznesit.

(si në janar 2003)	Fillimi i biznesit		Punësim dhe pushim*		Zbatimi i kontratës		
	Nr. i procedurave	Ditë	Fleksibiliteti i indeksit të punësimit	Fleksibiliteti i indeksit të pushimit	Nr. i procedurave	Ditë**	Kosto (në \$)
Shqipëria	11.0	47.0	33.0	15.0	37.0	220.0	794.0
Bosnia&Hecerg.	12.0	59.0	53.0	31.0	31.0	630.0	260.0
Kroacia	13.0	50.0	76.0	31.0	20.0	330.0	305.0
Maqedonia	13.0	48.0	65.0	32.0	27.0	509.0	750.0
Serbi&Mal i Zi	10.0	44.0	51.0	29.0	40.0	1,028.0	200.0
Ballkani perëndimor	11.8	48.6	55.2	28.0	29.4	579.5	347.0
ACCs***	9.6	48.6	39.1	34.0	19.4	624.1	69.2
BE	8.3	40.4	59.1	33.4	18.5	235.3	1,073.5

Burimi: Komisioni Evropian, 2004.

Shënim: 1) Indeksi varion nga 0 në 100, ku vlerat më të vogla tregojnë më pak fleksibilitet. Indeksi i "punësimit" mbulon mundësinë e kontratave me kohë të pjeshme e të plotë, ndërsa indeksi i "pushimit" fokusohet në mbrojtjen ligjore ndaj pushimit nga puna (bazat, procedurat, afatet e lajmërimit, pagesat për pushimet). 2) përfshin kohën e pritjes mes veprimit e zbatimit të kontratës. 3) ACCs – Vendet që po hyjnë e janë kandidatë të hyjnë në BE: Bullgaria, Republika Çeke, Hungaria, Latvia, Lituania, Polonia, Rumania, Republika Sllovaqe, Sllovenia.

Treguesi i parë "Fillimi i Biznesit", mat numrin e procedurave dhe të ditëve para përgatitjes për fillimin e aktivitetit në një biznes të ri. Numri i procedurave është pothuaj i njëjtë ndërmjet shteteve, por ai i ditëve ndryshon. Shqipëria ka një pozicion të mirë krahasuar me mesataren e gjithë Evropës Qendrore e Lindore, dhe është afër me mesataren e BE për këtë tregues.

Treguesi i "Punësim dhe pushim" përfaqëson fleksibilitetin e tregut të punës. Shqipëria është një përjashtim nga ngurtësia relativisht e lartë që tregon gjithë Ballkani Perëndimor në krahasim me vendet e tjera në tranzicion, përsa i përket indeksit të marrjes në punë si dhe atij të pushimit nga puna. Treguesi i Shqipërisë flet për një fleksibilitet të lartë në të dyja indekset.

Treguesi i tretë "Zbatimi i Kontratës", mat efikasitetin e sistemit gjyqësor në zbatimet e kontratave tregtare. Shqipëria ka numrin më

të vogël të ditëve që duhet pritur deri në pagesë, por ka një numër të konsiderueshëm procedurash që duhen ndjekur e që çojnë në koston më të lartë.

4.5.3.1. Mundësitë dhe stimujt për investitorët e huaj

Në një studim të kryer nga OECD (2003), bazuar në pyetësorët, takimet individuale, bisedat dhe shqyrtimin nga afër në vendet e Evropës Juglindore, materiali "Motivimet e investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri" citon:

"...kur investojnë në Shqipëri, investitorët e huaj marrin në konsideratë të gjitha pikat e forta e të dobëta që vendi u ofron atyre. Të pyetur për motivimin e tyre për të investuar në Shqipëri, pothuajse të gjithë të intervistuarit u përgjigjën se ata përpiqen të bëjnë një vlerësim dinamik të përparësive dhe mangësive të vendit. Ata mendojnë se përparësitë e Shqipërisë po rriten gjithnjë e më shumë. Ata besojnë se procesi i stabilizim-asociimit me Evropën dhe zbatimi i marrëveshjeve të tregtisë së lirë do ta përmirësojnë situatën në mënyrë të ndjeshme." (OECD, 2003, faqe 51.)

Pavarësisht nga vështirësitë dhe sfidat e shumta, Shqipëria është një vend që ofron mjaft mundësi për investitorët e huaj.

- Turizmi

Shqipëria është një vend i pasur me burime turistike, duke përfshirë malet, luginat, pyjet, lumenjtë dhe liqenet. Si një vend mesdhetar, ajo gëzon veçori si gjeografike ashtu dhe gjeologjike, me peisazhe të shumëllojshme, të cilat variojnë nga ato tipike mesdhetare në pjesën perëndimore dhe jugperëndimore, në të ndryshme në pjesën qendrore dhe në ato me male të thepisura në pjesën e brendshme të vendit. Vija bregdetare e detit Jon dhe e atij Adriatik ofron plazhe mjaft të bukura. Shqipëria është e pasur me liqene, lugina, rezerva natyrore, vende për gjueti, si dhe me llixha. Ajo gjithashtu, ka një histori dhe kulturë mjaft të lashtë.

Në periudhën afatgjatë, turizmi mund të jetë një nga faktorët kryesorë për tërheqjen e investitorëve të huaj, megjithatë aktualisht

Shqipëria ka një infrastrukturë të dobët për lehtësimin e investimeve të mëdha.

- Nafta dhe mineralet

Shqipëria është mjaft e pasur me burime natyrore, duke përfshirë kromin, qymyrgurin, nikelin, bakrin, naftën dhe gazin natyror. Është i vetmi vend në Evropë me rezerva të konsiderueshme të kromit. Para vitit 1990 ajo renditej e treta në botë për nxjerrjen e tij. Si industria e naftës, ashtu dhe ajo e minierave janë të orientuara drejt eksportit.

Sipas INOGATE (Programi Ndërshtetëror i Transportit të Naftës dhe Gazit në Evropë, financuar nga BE), Shqipëria vlerësohet të ketë rreth 550 milionë ton rezerva të rekuverueshme naftë, duke ofruar në këtë mënyrë kapacitete të mëdha eksportuese.

Sipas Agjencisë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja (2004) rezervat e gazit natyror të Shqipërisë vlerësohen të jenë rreth 3.316 miliardë metër kub. Industria e gazit në vend përqendrohet në 11 fusha, me një kapacitet vjetor prej 69 milionë metër kub. Megjithatë, kapaciteti i nxjerrjes së tij është shumë më i ulët dhe për përmbushjen e nevojave të vendit nevojitet importi i tij. Shqipëria është vendi i vetëm në Evropë që nuk është i lidhur me një gazsjellës ndërkombëtar. Ekzistojnë mjaft alternativa për zgjidhjen e kësaj çështjeje, duke përfshirë mundësinë e lidhjes me Italinë, Greqinë apo me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

- Industria përpunuese

Spektori i industrisë përpunuese ka tërhequr një numër të madh sipërmarrjesh të vogla në përpunimin e ushqimit, tekstileve, prodhimin e këpucëve, kryesisht me kompani greke dhe italiane. Industria e tekstileve ofron mundësi të shumta për investitorët e huaj, duke përbërë rreth 38 për qind të eksporteve, ku prodhimi i këpucëve llogaritet në më shumë se 21 për qind (fundi i vitit 2001). Pylltaria është një industri tradicionalisht e rëndësishme, ku industritë vendase të përpunimit të drurit në mbarë vendin furnizohen me lëndë të parë relativisht të lirë. Ky sektor ofron mjaft mundësi në prerjen e drurit, prodhimin e kompensatës, paneleve, mobilieve si dhe të mjeteve të zdrukthtarisë (EBRD, 2001).

- Bujqësia

Për vetë klimën dhe pozicionin e saj gjeografik, Shqipëria gëzon faktorë natyrorë të cilët mbështesin zhvillimin e bujqësisë. Prodhimet kryesore përfshijnë perimet, foragjeret, drithërat, frutat, vreshtat dhe ullinjët. Shqipëria ka mundësi të mëdha në arritjen e një industrie konkurruese agropërpunuese. Prodhimet bujqësore shqiptare përfshijnë: hortikulturën (kryesisht domatet), ullinjët, rrushin (i cili përdoret kryesisht për prodhimin e pijes alkolike vendore, rakisë), prodhimet blegtorale dhe bimët barishtore (veçanërisht sherbela, për të cilën Shqipëria konsiderohet si një prodhues i rëndësishëm botëror).

- Kostoja e ulët e krahut të punës

Sistemi arsimor në Shqipëri në mbarë vendin është i mirëkonsoliduar. Kohët e fundit janë zbatuar programe të mirënjohura pasuniversitare, si për shembull, programi i MBA-së, IFG-së dhe i Magjistraturës. Të dhënat statistikore mbi studentët, të cilët përfundojnë studimet e tyre jashtë vendit (veçanërisht në universitetet evropiane dhe amerikane) flasin për një përgatitje të mirë të tyre. Populli shqiptar dallohet për aftësinë e tij në studimin e gjuhëve të huaja, si për shembull të gjuhëve angleze, italiane, greke, franceze, gjermane dhe asaj spanjolle.

Një nga përparësitë që Shqipëria ofron për tërheqjen e investimeve të huaja direkte është kostoja e ulët e krahut të punës. Studime të ndryshme kanë dëshmuar se pagat në Shqipëri janë sa një e dhjeta e pagave në Itali. Paga mesatare mujore në vendin tonë për vitin 2004 ishte pak më shumë se 114 euro në muaj (KPMG, 2005).

4.5.3.1. Pengesat ndaj IHD-ve

Pothuajse të gjitha vrojtimit e biznesit dhe punët kërkimore që lidhen me pengesat në zhvillimin e biznesit, kanë arritur në përfundimin se faktorët kryesorë që ndikojnë në mosthithjen e investimeve të huaja direkte janë kuadri ligjor dhe rregullativ, si dhe infrastruktura. (Xhepa dhe Agolli, 2004.)

- Infrastruktura

Infrastruktura e dobët, duke përfshirë transportin dhe komunikacionin krijojnë barriera për zhvillimin e biznesit dhe të ekonomisë, në përgjithësi. Megjithë hapat e fundit për përmirësimin e infrastrukturës së transportit, Shqipëria ka linja të kufizuara rrugore, në përgjithësi në kushte jo të mira, linja të pakta hekurudhore dhe shërbim të pazhvilluar të transportit publik. Megjithëse nuk ekzistojnë shërbime të rregullta të transportit ajror tregtar brenda vendit, është e mundur që ky lloj transporti të sigurohet përmes marrjes me qira të avionëve të vegjël ose helikopterëve.

- Korrupsioni dhe mungesa e transparencës

Korrupsioni dhe mungesa e përgjithshme e transparencës mbeten sfida të vazhdueshme për demokracinë dhe për sipërmarrjet shumëkombëshe që mund të investojnë në Shqipëri. Megjithëse nuk është aq problematik sot sa shfaqej në vitet e mëparshme, korrupsioni vijon të jetë një pengesë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Ai mund të ndikojë në zgjatjen e procedurave të marrjes së licencave, duke i bërë ato mjaft të kushtueshme. Mitmarrja është një praktikë e zakonshme. Sipas perceptimit publik, institucionet më të korruptuara në Shqipëri janë doganat, shërbimi policor dhe sistemi i shëndetit publik. Transparenca pengohet më tej dhe nga fakti se një pjesë e madhe e veprimtarisë tregtare në Shqipëri zhvillohet jashtë ekonomisë formale. Sipas indeksit TI 2004 (i cili rendit vendet sipas shkallës së korrupsionit ndërmjet zyrtarëve publikë dhe politikanëve), Shqipëria vlerësohej me 2.5 nga 10 pikë (10 nënkupton shumë e pastër dhe 0 shumë e korruptuar). Shqipëria ishte një nga 60 vendet (nga 146 vende) që u vlerësua me më pak se 3 pikë nga 10 gjithsej, duke dëshmuar për një korrupsion në masë të madhe. (Transparency International, 2004.)

- Ekonomia informale

Në një raport të përgatitur nga OECD - Investment Compact for the Ministry of Economy of Albania (Marrëveshja e Investimeve për Ministrinë e Ekonomisë së Shqipërisë), thuhet se: "Ekonomia informale jep një kontribut të madh në punësimin dhe prodhimin në Shqipëri, por gjithashtu ajo përfaqëson një evazion fiskal dhe rregullator dhe si e tillë, është një çështje mjaft e debatueshme."

(OECD, 2004, faqe 9.) Megjithatë, ky “kontribut” ka një kosto të madhe përsa i përket të ardhurave të humbura nga taksat, mungesës së mbrojtjes së punonjësve dhe konkurrencës së pandershme ndërmjet ndërmarrjeve. Disa vlerësime optimiste shprehin se një e treta e totalit të veprimtarisë ekonomike në Shqipëri është informale, ndërkohë që vlerësime të tjera e llogarisin këtë shifër në 50 deri në 60 për qind të ekonomisë. Vlerësimi i OECD-së në raportin e lartpërmendur ishte se prodhimi informal gjatë pesë viteve të fundit, ka kontribuar në totalin e vlerës së shtuar bruto me 24 – 28 për qind. Kjo mbetet një shifër e lartë që ndikon negativisht tek të ardhurat nga taksat si edhe në qarkullimin e parasë në sistemin bankar e në ekonomi, e që në të njëjtën kohë perceptohet si pengesë nga investitorët e huaj.

4.5.1. Politikat e jashtme dhe përfshirja e Qeverisë

Ndër vendet në tranzicion, Shqipëria konsiderohet si një nga vendet më të hapura tregtare. Tarifat e importit janë nga më të ulëtat në rajon, shoqëruar me barriera shumë të kufizuara jotarifore dhe me disa marrëveshje rajonale të tregtisë së lirë (FMN, 2005). Promovimi i IHD-ve është një objektiv strategjik i Qeverisë. Në këtë kontekst, Qeveria ka arritur të realizojë:

- Krijimin e një kuadri ligjor dhe rregullativ me stimuj për investitorët e huaj (disa nga stimujt ligjorë përfshijnë: trajtimin e barabartë të investitorëve të huaj dhe të brendshëm; kthimin e fitimit dhe dividendit të plotë (pas taksës); kthimin në origjinë të fondeve në rast likuidimi të një kompanie). Përdorimi i arbitrazhit si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare tregtare është i shprehur qartë në ligjin shqiptar dhe Shqipëria merr pjesë në Gjykatën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID).

- Minimizimin e rrezikut të investimeve: Investimet e huaja në Shqipëri janë tërësisht të mbrojtura nga ligji. Ato nuk mund të kombëtarizohen, shpronësohen ose t’u nënshtrohen masave të tjera të ngjashme, përveç rasteve të veçanta të parashikuara me ligj si për shembull, rasti i interesit publik etj.. Gjithashtu, Shqipëria

ka nënshkruar Konventën e Agjencisë Shumëpalëshe të Garancisë të Investimeve (MIGA), Konventën e Nju Jorkut të vitit 1958 mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj, si dhe Konventën e Gjenevës mbi Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj. Palëve të angazhuara në çështje tregtare ndërkombëtare në Shqipëri u njihet e drejta të kërkojnë zgjidhje në një gjykatë vendore ose të huaj.

- Rritjen dhe përmirësimin e imazhit të Shqipërisë si një destinacion i besueshëm i IHD-ve.

- Krijimin e një institucioni të pavarur dhe të besueshëm për apelimin e çështjeve që lidhen me taksat dhe të ngjashme me to.

Shqipëria ka nënshkruar disa marrëveshje dypalëshe që lidhen me nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve të ndërsjella. Gjithashtu, ajo ka lidhur traktate dypalëshe me shumë vende, si dhe merr pjesë në disa organizata ekonomike ndërkombëtare. (Shiko aneksin 3: Marrëveshjet dypalëshe e rajonale të tregtisë.)

Me qëllim sigurimin financiar të subjekteve të sektorit privat që investojnë në Shqipëri, Banka Botërore ka dhënë asistencën e saj për Shqipërinë përmes krijimit të një "Political Risk Guarantee Facility" (PRGF). PRGF administrohet nga Agjencia Shqiptare e Garancisë (AGSH) dhe ndërmarrjet e përfshira në prodhim kanë të drejtën e aplikimit për dhënien e garancisë (me përjashtim të duhanit, alkolit dhe armëve).

Në gusht 1998, Qeveria Shqiptare krijoi Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin Ekonomik (AEDA), me qëllim nxitjen e investimeve dhe të eksporteve. Ajo u ofron investitorëve një gamë të gjerë informacioni mbi ligjet e rregulloret ekzistuese, përfshirë edhe ligjet përkatëse mbi krijimin e funksionimin e ndërmarrjeve.

Ndërkohë që në vitin 2002, Qeveria Shqiptare ngriti një agjenci tjetër, Agjencinë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja (ANIH), misioni i së cilës është nxitja dhe rritja e investimeve të huaja direkte dhe krijimi i një mjedisi sa më të favorshëm biznesi në Shqipëri. Agjencia u ofron investitorëve potencialë shërbime

para marrjes së vendimit të investimit, që përfshijnë: studime të ndërmarrja në sektorin ose fushën me interes; informacion për partnerë të mundshëm shqiptarë për investitorët e interesuar në ndërmarrje të përbashkëta dhe forma të tjera bashkëpunimi në biznes; informacion për mjedisin e biznesit në përgjithësi dhe kuadrin ligjor e fiskal në veçanti; vizita të organizuara në vendet me interes për investitorët.

Agjencia ofron gjithashtu edhe shërbime gjatë dhe mbas investimit, të cilat përfshijnë: ndërmjetësimin mes investitorit e administratës publike për përshejtimin e procedurave të ndryshme; ndërmjetësimin mes investitorëve të huaj e atyre vendas për realizimin e ndërmarrjeve të përbashkëta; krijimin e kontakteve direkte me investitorë ekzistues për t'u njohur me probleme që Shqipëria përballë aktualisht dhe përcjelljen e tyre tek Qeveria për zgjidhje; sigurimin e një baze të dhënash për investitorët e huaj mbi IHD-të në Shqipëri.

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

Kërkimet tregojnë se IHD ka qenë një faktor shumë i rëndësishëm në prodhimin ekonomik në vendet e CEE dhe SEE, gjatë viteve të tranzicionit. Lidhja e fortë mes IHD-së dhe PBB-së, siç tregoi analiza e korrelacionit në kapitullin 4, dëshmon për dy fakte: flukset në rritje të IHD-së kanë një impakt pozitiv në rritjen e fuqisë ekonomike të një vendi; dhe nivelet e larta të PBB-së janë një motivues i rëndësishëm për flukse më të larta IHD-je. Përfundimi i fundit shpjegon edhe një nga arsyet për modelin e ndryshëm që ka ndjekur zhvillimi i IHD-së në vendet e SEE dhe CEE.

Të dyja grupet e vendeve kanë ecur përpara që nga vitet 1990, kur ato dolën nga izolimi. Megjithatë, në SEE treguesit makroekonomikë janë akoma të dobët dhe struktura institucionale akoma jo shumë efikase. Vendet e CEE kanë bërë progres drejt integritit të tyre në Bashkimin Evropian, kanë tërhequr flukse më të larta IHD-sh, e po kthehen tashmë edhe në burim të IHD të drejtuar

jashtë. Nga ana tjetër, në Evropën Juglindore investitorët e huaj kanë reaguar ndaj paqëndrueshmërisë dhe mungesës së zhvillimit, duke mos i preferuar këto vende si mundësi investimi.

Të dhënat e analizuara tregojnë se gjatë viteve 1992-2004, vendet e Evropës Juglindore kanë përfituar nga flukset e kapitalit të huaj dhe ekspertizë në këtë fushë vetëm në mënyrë sporadike dhe mjaft të kufizuar. Flukset kryesore të IHD-ve në këto vende janë lidhur më së tepërmi me privatizimet. Kapitali i huaj është investuar kryesisht në industrinë përpunuese, shërbimet financiare, telekomunikacion dhe tregti, dhe në pjesën më të madhe e ka origjinën nga vendet e BE-së. I gjithë rajoni ofron burime të pasura në turizëm, ndonëse në këtë fushë IHD-të mbeten mjaft të kufizuara (me përjashtim të Kroacisë).

Përsa i përket Shqipërisë, 15 vitet e tranzicionit janë karakterizuar nga një numër krizash që kanë patur një ndikim të madh mbi ekonominë e vendit. Megjithatë, pavarësisht nga ky fakt, gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka patur një rritje të konsiderueshme të PBB-së, inflacion të ulët dhe qëndrueshmëri të kursit të këmbimit.

Shqipëria gëzon mundësi të mëdha për tërheqjen e IHD-ve në sektorë të ndryshëm (si në industrinë përpunuese, agropërpunuese, bujqësi, turizëm dhe shërbime të tjera). Megjithatë, ajo renditet ndër vendet me tërheqjen më të ulët të kapitalit të huaj brenda rajonit, duke regjistruar nivele shumë më të ulëta të IHD-ve, sesa mundësitë e saj reale. Investimet e huaja gjatë këtyre viteve kanë ardhur kryesisht si rezultat i privatizimit të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha shtetërore, me përqendrim më të madh në industritë e punës. Vendet me investim më të madh në Shqipëri, janë Greqia dhe Italia.

Niveli i ulët i flukseve hyrëse dhe *stock*-ut të IHD-ve në vend, dëshmon faktin se ende ekzistojnë barriera të mëdha për investimet. Përmasat e vogla të tregut të brendshëm krahasuar me një pjesë të vendeve të rajonit dhe problemet e trashëguara nga e kaluara mund të konsiderohen si pengesa, e megjithatë nuk përbëjnë problemin kryesor me të cilin përballen investitorët e huaj.

Siç u analizua në pjesën e fundit të kapitullit 4, pengesat kryesore ndaj IHD në Shqipëri lidhen me zhvillimet e përgjithshme politike dhe të sigurisë në vend; me paqëndrueshmërinë dhe progresin e pamjaftueshëm gjatë procesit të tranzicionit dhe reformave strukturore; korrupsionin dhe praktikën e pandershme; kushtet jo të mira të infrastrukturës fizike; ndryshimet e shpeshta të kuadrit rregullativ; pengesat administrative; si dhe ekzistencën në masë të madhe të një ekonomie informale.

5.2. REKOMANDIME TË MUNDSHME DHE NDIKIMET E POLITIKËS

Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekjet e tyre për përmirësimin e mjedisit të biznesit, me qëllim rritjen e flukseve hyrëse të IHD-ve. Një nga masat më të rëndësishme që mund të ndërmerret nga qeveria për nxitjen e investimeve të huaja, është heqja e barrierave që lidhen me IHD-të në mënyrë që të përmirësohet klima e investimeve në Shqipëri dhe perceptimi i saj nga investitorët e huaj.

Një problem kryesor që ndikon jo vetëm IHD-të është korrupsioni. Me qëllim lehtësimin e investimeve të huaja, një masë e rëndësishme do të ishte eliminimi i rregulloreve të panevojshme (të cilat krijojnë hapësira për mitmarrje dhe korrupsion). Rregulloret e tjera duhet të jenë më tepër transparente dhe të përgjegjshme.

Kuadri ligjor duhet të përforcohet, jo vetëm në aspektin e legjislacionit, por edhe të zbatimit të tij dhe transparencës që lidhet me të, me rregulloret dhe procedurat.

Zvogëlimi i përmasave të ekonomisë informale do të ndihmonte jo vetëm në përmirësimin e ekonomisë në aspektin makroekonomik, por gjithashtu do të eliminonte pengesën më të madhe të biznesit të ligjshëm, që është konkurrenca e pandershme.

Infrastruktura (duke përfshirë energjinë elektrike dhe ujin) ka nevojë për një zgjidhje, me qëllim nxitjen e investimeve të huaja në të gjithë Shqipërinë. Rritja e investimeve publike në infrastrukturë nuk është zgjidhja e vetme; përpjekje mund të bëhen në drejtim të

tërheqjes së projekteve të huaja në këtë fushë, përmes ofrimit të stimujve të veçantë.

Përsa i përket kuadrit ligjor mbi taksat, Shqipëria tashmë ka lidhur marrëveshje dypalëshe me shumë vende në lidhje me taksat. Megjithatë, për të tërhequr më tepër investime të huaja, këto marrëveshje duhet të zgjerohen dhe me vende të tjera, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në tregjet ndërkombëtare, si për shembull me vende të Evropës Perëndimore (siç është Mbretëria e Bashkuar) dhe me SHBA-në.

Së fundi, Qeveria Shqiptare mund të inkurajojë zhvillimin e zonave të veçanta gjeografike brenda vendit, të cilat përfaqësojnë zona me mundësi të mëdha investimi në vend, duke u përpjekur ta bëjë të gjithë vendin më tërheqës. Zona të tilla janë ato industriale ose turistike (si për shembull, zonat bregdetare). Zhvillimi i këtyre zonave mund të kërkojë investime dhe burime të mëdha, megjithatë fillimisht mund të ndërmerren projekte pilote, të cilat mund të vihen në zbatim në plan më të gjerë pas funksionimit të tyre.

LITERATURË:

- ANIH, (2004), *An Investor's Guide to Albania*, Albania: Albanian Foreign Investment Promotion Agency
- Banka e Shqipërisë, *Buletini i Bilancit të Pagesave 2004*, Tiranë: Publikime të Bankës së Shqipërisë
- Banka e Shqipërisë, *Vrojtim mbi Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri*, Tiranë: Publikime të Bankës së Shqipërisë, 2005
- Bevan, A. A. and Estrin, S., (2000), *The Determinants of Foreign Direct Investment in Transition Economies*, WDI Working Paper No. 342
- Blomstrom, M., (1989), *Foreign Investments and Spillovers*, New York: Routledge
- Blomstrom, M. and Kokko A., (1998), "Multinational corporation and spillovers", *Journal of Economic Surveys*, vol. 12, Issue 3, page 247 – 277
- Brewer, T. L., (1993), "Government Policies, Market Imperfections, and Foreign Direct Investment", *Journal of International Business Studies*, First Quarter, page 101-117
- Broadman, H. G., Anderson, J., Claessens, C. A., Ryterman, R., Slavova, S., Vagliasindi, M., and Vincelette, G. A., (2004), *Building Market Institutions in South Eastern Europe: Comparative Prospects for Investment and Private Sector Development*, Washington D.C.: The World Bank
- Buckley, P. J. and Casson, J., (1976), *The Future of Multinational Enterprise*, London: Macmillan
- Buckley, P.J. and Ghauri, P.N., (1994), *The Economics of Change in East and Central Europe: Its Impact on International Business*, London: Academic Press Ltd
- Caves, R. E., (1971), "International Corporations: The Industrial Economics of Foreign Investment", *Economica*, Vol. 38, No. 2, page 1-27
- Collis, J. and Hussey, R., (2003), *Business Research*, 2nd edition, Basingstoke: Palgrave Macmillan
- Dunning J. H., (1981), *International production and the multinational enterprise*, London: Allen & Unwin
- Dunning, J. H., (1993), *Multinational Enterprises and the Global Economy*, Wokingham: Addison – Wesley
- Dunning, J. H. (1994), "The Prospects for Foreign Direct Investment in Central and Eastern Europe." in Buckley, P.J and Ghauri, P. N. (eds.), *The Economics of Change in East Europe – its Impact on International Business*, UK: Academic Press Ltd.
- Dunning, J. H. and Rugman, A. M., (1985), "The Influence of

Hymer's Dissertation on the Theory of Foreign Direct Investment", *The American Economic Review*, Vol. 75, No.2, page 228-232

Demekas, D., Horváth, B., Ribakova, E. and Wu, Y., (2005), *Foreign Direct Investment in Southeastern Europe: How (and How Much) Can Policies Help?*, IMF Working Paper No. 110

EBRD, (1994), "Economic Transition in Eastern Europe and the Former Soviet Union", *Transition Report*, United Kingdom: EBRD Publication Desk

EBRD, (2001), *Albania: Investment Profile 2001*, [online], Available at: <<http://www1.oecd.org/daf/SPAIcom/pdf/EBRD-InvestProfile-Alb-2001.pdf>>, [Accessed on 26 July, 2005]

EBRD, (2004), *Spotlight on south-eastern Europe: An overview of private sector activity and investment*, London: EBRD

European Commission, (2004), *The Western Balkans in transition*, Occasional Paper no. 5 [online], Available at: <http://europa.eu.int/comm/economy_finance>, [Accessed on 28 August 2005]

Hood, N. and Young, S., (1979), *The Economics of Multinational Enterprise*, Longman Group Limited

Hunya, G., (2004), *Foreign Direct Investment in South-East Europe 2003-2004*, Vienna (WIIW): Vienna Institute for International Economic Studies

IMF, (1993), *Balance of Payments Manual*, 3rd edition, Washington, D.C.: IMF Publications

IMF, (1994), "Albania", *Economic Reviews*, No.5, Washington D.C. IMF Publications

IMF, (1997), *World Economic Outlook*, Washington, D.C.: IMF Publications

IMF, (2005), *Albania – IMF Country Report*, No. 05/89, Washington D.C. IMF Publications

INOATE, (no date), *The Republic of Albania – Energy*, [online], Available at: <http://www.inogate.org/html/countries/energy/albania_en.htm>, [Accessed on 30 July 2005]

Knickerbocker, F., (1976), *Market Structure and Market Power Consequences of Foreign Direct Investments by Multinational Corporations*, Washington: Center for Multinational Studies

Kogut, B., (1985), "Designing Global Strategies: Profiting from Operational Flexibility", *Sloan Management Review*, Fall: page 7-38

Kojima, K., (1978), *Direct Foreign Investment*, London: Croom Helm

Konings, J. (2000), *Effects of direct foreign investment on domestic firms: Evidence from firm level panel data in emerging economies*,

WDI Working paper, no. 344
 KPMG, (2003), *Investment in Albania*, 3rd edition, Albania: KPMG Albania Shpk
 KPMG, (2005), *Central and Eastern European Country Snapshots, 2005*, KPMG Central and Eastern Europe Ltd
 Krkoska, L., (2001), *Foreign Direct Investment Financing of Capital Formation in Central and Eastern Europe*, EBRD Working paper, no. 67
 Kule, Dh. dhe Hadëri, S., (2001), *Konsolidimi Makroekonomik: Arritje dhe Sfida*, Tiranë: Publikime të Bankës së Shqipërisë
 Lall, S. and Streeten, P., (1977), *Foreign Investment, Transnationals and Developing Countries*, London: The Macmillan Press LTD
 Lavigne, M., (1995), *The Economic of Transition: From Socialist Economy to Market Economy*, Hampshire and London: Macmillan Press Ltd
 Lankes, H.P. and Venables, A.J., (1996), "Foreign direct investment in economic transition: The changing pattern of investments", *The Economics of Transition*, Vol. 4, Issue 2, page 331-47
 London, B. and Ross, R. J.S., (1995), "The Political Sociology of Foreign Direct Investment: Global Capitalism and Capital Mobility, 1965-1980", *International Journal of Comparative Sociology*, Vol. 36, no. 4, pp. 198-219
 Meyer, K., (1998), *Direct Investment in Economies in Transition*, Cheltenham: Edward Elgar Publishing
 Moosa, I. A. (2002), *Foreign Direct Investment – Theory, Evidence and Practice*, New York: Palgrave
 Muent, H., Pissarides F. and Sanfey P., (2000), *Taxes, Competition and Finance for Albanian Enterprises: evidence from a field study*, EBRD: Working Paper no. 54
 Narula, R., (1996), *Multinational Investment and Economic Structure*, London and New York: Routledge
 Neale, B. and Pass, C., (1990), "Foreign Direct Investment: Potential Costs and Benefits for Host and Source Countries", *Management Accounting*, Vol.68, Issues 2, page 32-49
 Nunnenkamp, P. and Spatz, J., (2003), *Foreign Direct Investment and Economic Growth in Developing Countries: How Relevant Are Host-country and Industry Characteristics?*, Kiel Working Paper, No. 1176
 OECD, (1994), *Assessing Investment Opportunities in Economies in Transition*, Paris: OECD
 OECD, (1996), *Benchmark Definition of Foreign Direct Investment*, 3rd edition, Paris: OECD

OECD, (1998), *Open Market Matter: The Benefits of Trade and Investment Liberalization*, Paris: OECD

OECD, (2003), *National Treatment of International Investment in South East European Countries: Measures Providing Exceptions*, [online], Available at: <<http://www.oecd.org/dataoecd/2/41/206372.pdf>>, [Accessed on 18 August, 2005]

OECD - Investment Compact, (2004), *The Informal Economy In Albania: Analysis And Policy Recommendations*, OECD and CEI Publication

OECD, (2005), *Revision of the Benchmark Definition of Foreign Direct Investment*, [online], Available at: <<http://www.oecd.org/.html>>, [Accessed on 25 July 2005]

Paliwoda, S.J., (1995), *Investing in Eastern Europe; Capitalizing on Emerging Markets*, UK: Adison – Wesley Publishers LTD

Palmade V. and Anayiotas A., (2004) *Public Policy for Private Sector: FDI Trends*, World Bank, Working Paper no. 273

Pavlinek, P., (2004), *Regional Development Implications of Foreign Direct Investment in Central Europe*, London: SAGE Publications

Petrakos G., (1996), *The new Geography of the Balkans: Cross-Border Cooperation Between Albania, Bulgaria and Greece*, Volos: University of Thessaly Press

Porter, M., (1990), *The Competitive Advantage of Nations*, London: Macmillan

Resmini, L., (2000), "The determinants of foreign direct investment in the CEECs: New evidence from sectoral patterns", *The Economics of Transition*, Vol. 8, Issue 3, page 665-689

Robertson, D., (1993), *A Dictionary of Modern Politics: A guide to the complex ideology and terminology which surrounds the world of politics*, 2nd edition, London: Europa Publications Limited

Rugman, A. M. and Hodgetts, R. M. (1995), *International Business: A strategic management approach*, New York: McGraw Hill

Schmidt, K. D., (1995), "Foreign Direct Investment in Eastern Europe: State-of-the-art and Prospects." in Dobrinsky, R. and Landesmann, M. (eds.), *Transforming Economies and European Integration*, Aldershot, UK: Edward Elgar

SIGMA (2002), *Sigma Balkans Report 2002: Republic Of Albania, Trade Policy*, OECD and European Commission

Transparency International, (2004), *Transparency International Corruption Perceptions Index 2004*, [online], Available at: <<http://www.transparency.org/cpi2004.html>>, [Accessed on 9 September, 2005]

UNCTAD, (no date), *Statistical Databases*, [online], Available at:


<<http://www.unctad.org/Templates/Page.asp?intlItemID=1888&lang=1>>, [Accessed on 15 July 2005]
UNCTAD, (1998), *World Investment Report 1998: Trends and Determinants*, United Nations
UNCTAD, (2002), *World Investment Report 2002: Transnational Corporations and Export Competitiveness*, United Nations
UNCTAD, (2004a), *World Investment Report 2004: The Shift towards Services*, United Nations
UNCTAD, (2004b), *Prospects for Foreign Direct Investment and the Strategies of Transnational Corporations 2004-2007*, United Nations
UNECE, (2005), *Economic Survey of Europe 2005*, Geneva: United Nations Publications
Vernon, R., (1966), "International Investment and International Trade in Product Cycle", *Quarterly Journal of Economics*, vol. 80, page 190 – 207
Vernon, R., (1974), "Competition Policy Towards Multinational Corporation", *The American Economic Review*, Vol.64, No.2, page 276-282
Williamson, O., (1975), *Markets and Hierarchies: Analysis and Antitrust Implications*, New York: Free Press
Wint, A. G., (1992), "Liberalizing Foreign Direct Investment Regimes: The Vestigial Screen", *World Development*, Vol. 20, Issue 10, page 1515-1529
Xhepa, S. and Agolli, M., (2004), *Small And Medium-Sized Enterprises Development*, Tirana: ISB & ACIT Publications

ANEKS 1. SHKURTIMET PËR EMRAT E SHTETEVE TË PËRDORURA NË GRAFIKË


SHQ	Shqipëria
BUL	Bullgaria
BH	Bosnja dhe Hercegovina
RÇEKE	Republika Çeke
KRC	Kroacia
HUN	Hungaria
MAQ	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
POL	Poloni
RUM	Rumania
SMZ	Serbia dhe Mali i Zi
SLO	Slllovakia
SLLV	Slllovenia

ANEKS 2. LIDHJA NDËRMJET PBB-SË DHE IHD-SË

Të dhënat për IHD dhe PBB në vendet e CEE, në milionë dollarë, 1992-2004.



Të dhënat për IHD dhe PBB në vendet e SEE, në milionë dollarë, 1992-2004.



ANEKS 3. MARRËVESHJET DYPALESHE E RAJONALE TË TREGTISË

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm përpara në hapjen e saj ndaj tregjeve rajonale e ndërkombëtare. Procesi i integritimit rajonal, që konsiderohet të jetë një hap përpara drejt integritimit Evropian të vendit, mbështetet plotësisht nga qeveria.

Shqipëria ka kontribuar aktivisht për krijimin e një rrjeti MArrëveshesh të Tregtisë së lirë (MTL) në rajon, në zbatim të angazhimeve që rrjedhin nga memorandumit i Mirëkuptimit për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë në vendet e Evropës JugLindore e të respektimit të të gjithë afateve kundrejt komunitetit ndërkombëtar dhe në mënyrë të veçantë në kuadër të procesit të Stabilizim - Asociimit me Bashkimin Evropian. Tashmë Shqipëria ka përfunduar këtë Rrjet me vendet nënshkruese të Memorandumit, si dhe me UNMIK/Kosovë.

MTL në rajon dhe me BE deri tani përfshijnë: Deklaratë ndërmjet Shteteve të Shoqatës së Tregtisë së Lirë Evropiane (EFTA) dhe Shqipërisë; Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me UNMIK/Kosovë; me Moldavinë; me Serbinë dhe Malin e Zi; me Rumaninë; me Bosnje Hercegovinën; me Bullgarinë; me Maqedoninë; me Kroacinë; Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Komunitetit Evropian e Shteteve të tij anëtare dhe Republikës së Shqipërisë; Marrëveshja e Përkohshme mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar (INTERIM) ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë.

Shqipëria ka firmosur gjithashtu marrëveshje për Nxitjen dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve me shumë vende si: Bashkimi Belgo-Luksemburgas; Ukraina; Maqedonia; Sllovenia; Shba; Turqia; Austria; Bullgaria; Danimarka; Egjypt; Gjermania; Rusia; Suedia; Anglia; Çekia; Holanda; Malajzia; Rumania; Austria; Kroacia; Polonia; Tunizia; Zvicra.

Marrëveshje të Taksimit të Dyfishtë janë firmosur e janë të aplikueshme me vende si: Polonia, Rumania, Malajzia, Hungaria, Turqia, Republika Çeke, Rusia, Maqedonia, Kroacia, Bullgaria, Italia, Suedia; Norvegjia, Greqia, Malta, Zvicra, Belgjika, Franca, dhe Moldavia.

Marrëveshje me OBT-në përfshijnë Negociatat shumëpaleshe në Organizatën Botërore të Tregtisë si: Skeduli i Konkensioneve Tarifore për Hyrjen në Treg të Mallrave; Skeduli i Bujqësisë i depozituar pranë OBT-së; Memorandumi i Licencimit në Importe; Letra e Referencës së Shërbimeve të Telekomunikacioneve; Skeduli i Shërbimeve i depozituar pranë OBT-së; Angazhimet që Shqipëria ka marrë në kuadrin e Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë në Shërbime.

Gjithashtu, Shqipëria është anëtare dhe palë në shumë nga marrëveshjet e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Xhaferaj, Endrita

Investimi i Huaj Direkt në vendet në zhvillim të Evropës

Lindore: Rasti i Shqipërisë / Endrita Xhaferaj - Tiranë:

Banka e Shqipërisë, shtator, 2005

-68 f; 15.3 x 23 cm. (material diskutimi 4)

Bibliogr.

ISBN 99943-864-3-3

339.727.22(4/9:496.5) "1991/2006

339.727.22(4/9:4-12) "1991/2006

338.2(496.5) "1991/2006

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonti në adresën:

*Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-222152;
Faks: +355-(0)4-223558
ose duke dërguar një e-mail në adresën:*

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 500 kopje